

MCI

management consulting institute

	
REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development	
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	01/3
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	2008
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	—
Data Datum Date	07-08-15
PRISHTINË/A	

Vlerësimi i Performancës dhe Efektshmërisë së Bordeve të Ndërmarrjeve Publike

Drejtuar:

Njësisë për Politikat dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

Përgatitur nga :

N.Sh. Management Consulting Institute

Data e dorëzimit: 07.08.2015

Shkurtesat

AB	Auditori i Brendshëm
AJ	Auditori i Jashtëm
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
ANP “KONTROLLI AJROR”	ANP - Kontrolli Ajror “Ademi Jashari” sh.a.
BD	Bordi i Drejtorëve
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
HK-TK	Hekurudhat e Kosovës-TrainKos
HK-IK	Hekurudhat e Kosovës-InfraKos
KA	Komisioni i Auditimit
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
KMD	Kompania për Menaxhimin e Deponive sh.a.
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a.
KRU HIDRODRINI, PEJË	Kompania Rajonale e Ujësllësit dhe Kanalizimit sh.a.
KRU HIDROMORAVA, GJILAN	Kompania Rajonale e Ujësllësit Hidromorava sh.a.
KRU HIDROREGJIONI – JUGOR, PRIZREN	Kompania Rajonale e Ujësllësit Hidroregjioni – Jugor sh.a.
KRU MITROVICA	Kompania Rajonale e Ujësllësit Mitrovica sh.a.
KRU PRISHTINA	Kompania Rajonal e Ujësllësit Prishtina sh.a.
KRU RADONIQI, GJAKOVË	Kompania Rajonale e Ujësllësit Radoniqi sh.a.
KRU	Kompani Regjionale e Ujësllësit
KU DRINI I BARDHË	Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë sh.a.
KU RADONIQI - DUKAGJINI	Kompania e Ujitjes Radoniqi – Dukagjini sh.a.
KU	Kompania e Ujitjes
Ligji mbi NP	Ligji mbi Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087
MCI	N.SH. Management Consulting Institute
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrjet Publike
NPH IBËR–LEPENC	Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër-Lepenc sh.a.
NJPMNP	Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
PB	Plani i Biznesit
PF	Pasqyrat Financiare
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet/Rreziqet
UD	Ushtrues Detyre

Përmbajtja

Hyrje.....	5
Qëllimi.....	5
Kriteret e Vlerësimit.....	5
Metodologjia e përdorur	6
Intervistimi i Drejtorëve të Bordit.....	6
Të dhënat Sekondare	6
Dokumentet e analizuar.....	7
Ndërmarrjet e Vlerësuara	7
Ndërmarrjet Publike Qendrore.....	7
Kompanitë Rajonale të Ujitjes	8
Kompanitë Rajonale të Ujësllësit	8
Vlerësimi Përmbledhës	9
Vlerësimi i performancës së NP-ve Qendrore dhe Efektshmërisë së Bordeve të Drejtorëve	10
Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	10
Posta e Kosovës sh.a.....	14
Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.....	18
Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT	22
HK Trainkos sh.a.....	26
Infrakos sh.a.....	30
ANP - Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a.	34
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.	38
N.P.H. Ibër-Lepenc sh.a.....	42
Vlerësimi i performancës së Kompanive Rajonale të Ujitjes	47
KU Drini I Bardhë sh.a	47
KU Radoniqi – Dukagjini sh.a.	51
Vlerësimi i performancës së Kompanive Rajonale të Ujësllësit.....	56
KUR Prishtina sh.a.....	56
KRU Hidrodrini - Pejë sh.a.....	60
KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.	65
KRU Mitrovica sh.a.....	69
KRU Hidromorava sh.a.....	74
KRU Radoniqi – Gjakovë sh.a.....	78
Shtojcat	83
Pyetësorët për Vlerësimin e Bordeve	83
Pyetësori: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	83
Pyetësori: Posta e Kosovës sh.a	88
Pyetësori: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.....	93
Pyetësori: Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT	98
Pyetësori: HK Trainkos sh.a.....	103
Pyetësori: Infrakos sh.a.....	108
Pyetësori: ANP - Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a.	113
Pyetësori: Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.	118
Pyetësori: HS Ibër Lepenci sh.a.....	123
Pyetësori: KU Drini i Bardhë sh.a	128
Pyetësori: KU Radoniqi – Dukagjini sh.a.	133

Pyetësori: KUR Prishtina sh.a	138
Pyetësori: KRU Hidrodrini - Pejë sh.a.....	143
Pyetësori: KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.	148
Pyetësori: KRU Mitrovica sh.a.....	153
Pyetësori: KRU Hidromorava sh.a.....	158
Pyetësori: KRU Radoniqi – Gjakovë sh.a.	163
Procesverbalët për zhvillimin e intervistave.....	168
Procesverbali: Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a.	169
Procesverbali: Posta e Kosovës sh.a.	170
Procesverbali: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.	171
Procesverbali: Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT	172
Procesverbali: HK Trainkos sh.a.	173
Procesverbali: Infrakos sh.a.	174
Procesverbali: ANP – Kontrolli Ajror “ Adem Jashari” sh.a.	175
Procesverbali: Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.....	176
Procesverbali: N.P.H. Ibër-Lepenc sh.a.	177
Procesverbali: KU Drini i Bardhë sh.a.....	178
Procesverbali: KU Radoniqi – Dukagjini sh.a.....	179
Procesverbali: KUR Prishtina sh.a.	180
Procesverbali: KRU Hidrodrini - Pejë sh.a.	181
Procesverbali: KUR Hidroregjioni Jugor sh.a.....	182
Procesverbali: KRU Mitrovica sh.a.	183
Procesverbali: KRU Hidromorava sh.a.	184
Procesverbali: KRU Radoniqi - Gjakovë sh.a.	185

Hyrje

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 23, në kuadër të Lista 1 hyjnë 17 ndërmarrje dhe atë 9 ndërmarrje janë Ndërmarrje Publike Qendrore, 2 ndërmarrje janë Kompani Rajonale të Ujitjes dhe 6 ndërmarrje janë Kompani Rajonale të Ujësjetës; ndërsa, në listën 2 hyjnë 21 ndërmarrje me pronësi publike.

Në bazë të Ligjit mbi NP, neni 15.1, të gjitha ndërmarrjet publike duhet të kenë një bord të drejtore të përberë prej 5 ose 7 anëtarësh. Ky bord ka për detyrë mbikëqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë së zyrtareve të lartë dhe kompanisë në tërësi. Nëse performanca e një ndërmarrje devijon nga caqet e planifikuara ose ka performacë të dobët për dy vjet radhazi; atëherë aksionari, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës rekomandon dhe bën shkarkimin e tyre si bord për mos angazhimin maksimal performance jo të mirë.

Për të vlerësuar punën e tyre, është themeluar Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për të kryer detyra të veçanta dhe për t'i ardhur në ndihmë aksionarit. Ligji mbi Ndërmarrjet Publike është akti ligjor që ka nxjerre këtë njësi dhe i ka dhënë pos përgjegjësi të tjera edhe vlerësimin e efektshme risë së Bordeve. Sipas këtij Ligji, neni 28.3, NJPMNP në baza vjetore do të vlerësojë efektshmerinë e Drejtorëve të Bordeve të secilës ndërmarrje. Gjithashtu, kjo njësi mund edhe të angazhojë këshilltarë profesional ose kompani konsulente për t'i ardhur në ndihmë në kryerjen e këtij vlerësimi.

Për vlerësimin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014 si kompani konsulente është zgjedhur N.Sh. Management Consulting Institute – MCI.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij projekti është vlerësimi i performancës së Bordeve të NP që janë në pronësi të Qeverisë Qendrore, respektivisht të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore, kompanive rajonale të ujitjes si dhe kompanive rajonale të ujësjetës. Vlerësimi i performancës së bordeve do të jetë i bazuar nëse të njëjtat janë duke kryer punën e tyre konform Ligjit mbi NP, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe praktikave më të mira të qeverisjes së ndërmarrjeve publike.

Gjatë procesit të vlerësimit, MCI është mbikëqyrur nga Komisioni i emëruar nga NJPMNP, si organ kompetent për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

MCI vlerësimin e performancës së Bordeve të NP e ka kryer në mënyrë të pavarur dhe në asnjë fazë të këtij procesi nuk ka pasur kurrfarë interference nga asnjëra palë e përfshirë në këtë proces, qoftë nga Ndërmarrjet e vlerësuara apo nga NJPMNP.

Vlerësimi i performancës së Bordeve të NP është bërë nga pyetësorë të siguruar nga NJPMNP me qëllim të përcaktimit të njohurive të Drejtorëve të Bordit me obligimet e tyre që dalin nga Ligji mbi NP dhe Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, dhe më pak është koncentruar në performancën financiare dhe operative të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, vlerësimi nuk është marr me kompensimet e Drejtorëve të Bordit dhe arsyeshmërisë së tyre, sepse për këtë çështje ekziston raporti i zyrës së Auditorit të Përgjithshëm që e ka precizuar këtë çështje, respektivisht raporti i auditimit për kompensimet e bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike qendrore për periudhën 2009-2012 aprovuar në gusht të vitit 2014.

Kriteret e Vlerësimit

MCI është bazuar në kriteret e mëposhtme për të përgatitur vlerësimin mbi efektshmërinë së Bordeve të ndërmarrjeve publike në pronësi të Qeverisë Qendrore:

- Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja
- Zhvillimi dhe Performanca e KE-së
- Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve
- Shkalla e Përthithjes së Fondeve
- Performanca e Bordit
- Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore
- Komitetet e Bordit
- Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e secilit kriter më lartë janë përdorur nën kritere të ndryshme në mënyrë që të arrihet një vlerësim më objektiv dhe gjithëpërfshirës për kriteret në fjalë.

Metodologjia e përdorur

Metodologjia e përdorur për të bërë vlerësimin e efektshmërisë së Bordeve të Ndërmarrjeve Publike në pronësi të Qeverisë Qendrore konsiston në kombinim të të dhënave primare dhe sekondare.

Intervistimi i Drejtorëve të Bordit

Për të arritur qëllimin e projektit janë intervistuar Drejtorët e Bordeve të Ndërmarrjeve në pronësi të Qeverisë Qendrore. Ndërmarrjet publike në pronësi të Qeverisë Qendrore të cilat kanë qenë pjesë e këtij procesi të vlerësimit i kanë pasur nga dy deri në gjashtë Drejtor të Bordit.

Zhvillimi i intervistave është bërë me Drejtorët e Bordit përmes një pyetësori të strukturuar që ka përmbajtur pyetje të ndryshme për vlerësimin e tetë kritereve të përcaktuar më lartë dhe atë nga planifikimi strategjik deri te mbledhjet e Bordit. Aplikimi i kritereve gjatë procesit të vlerësimit ka qenë i njëjtë, standard dhe i unifikuar për të gjitha ndërmarrjet publike të përfshira në këtë vlerësim. Kriteret në fjalë janë përcaktuar nga ana e NJPMNP dhe vlerësimi i MCI-së si kompani konsulente është bazuar konform kritereve të përcaktuar duke mos devijuar në vlerësimin e të njëjtave.

Nga intervistat që janë zhvilluar me Drejtorët e Bordit të Ndërmarrjeve Publike të vlerësuara është përjashtuar Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjeve respektive. Arsyeja e një veprimi të tillë është fakti se Bordi i Kompanisë Publike Qendrore do të bëjë vlerësimin e performancës së Kryeshefit Ekzekutiv të kompanisë përkatëse.

Zhvillimi i intervistave është bërë në premisat e ndërmarrjet publike qendrore, në lokacionet e caktuara nga ana e tyre. Për Zhvillimin e Intervistave është mbajtur Procesverbal ku dëshmohet data, koha për zhvillimin të intervistave i nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm/ Këshilltari i Korporatës së ndërmarrjeve në fjalë.

Të dhënat Sekondare

Stafi i kompanisë MCI ka bërë mbledhjen dhe analizën e të gjitha dokumenteve relevante të Ndërmarrjeve Publike në pronësi të Qeverisë Qendrore për të arritur një vlerësim sa më kompetent mbi vlerësimin e efektshmërisë së të njëjtave. Të dhënat sekondare janë siguruar nga ndërmarrjet publike qendrore dhe nga NJPMNP konform kërkesave të kompanisë konsulente, MCI-së.

Ndërmarrjet publike qendrore që janë vlerësuar kanë bashkëpunuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe kanë ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara me qëllim të arritjes së një vlerësimi sa më objektiv dhe të kompletuar.

Dokumentet e analizuara

Në kuadër të dokumenteve që janë analizuar për të bërë vlerësimin e efektshmërisë së Bordeve ka pasur ligje të aprovuar, rregullore interne dhe eksterne, procesverbale, raporte, përshkrime të punës dhe dokumente tjera relevante për këtë vlerësim. Disa nga dokumentet e analizuara nga MCI për të bërë vlerësimin e efektshmërisë së Bordeve kanë qenë:

- Politika mbi Çështjet Financiare
- Politika mbi Punësimin
- Politika mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësiwe Sociale Korporative
- Procesverbalet e Mbledhjeve të Bordit si dhe çdo Dokument tjetër që mbështet Procesin e Aprovimit të Buxhetit
- Përshkrimin e Punës së KE-së
- Vlerësimin që i është bërë Performancës së KE-së
- Planit të Zhvillimit Profesional të KE-së
- Raporte Mujore në bazë Kampioni
- Raporteve Vjetore të Ndërmarrjeve Publike
- Raportet Relevante Mujore me Përzgjedhje në bazë Kampioni
- Proces-verbalet e mbledhjeve të Bordit dhe Komiteteve Aktive
- Raportet e Duhura Tre-mujore me Përzgjedhje në bazë Kampioni
- Komentet, Vërejtjet dhe Kërkesat e NJPMNP drejtuar Bordeve
- Politika e Shpenzimeve dhe Dieta për Udhëtime Pune si dhe Politikën e Shpenzimeve te Përfaqësimit
- Raportet e Auditorit të Jashtëm si dhe Planin e Masave që do të merren nga Menaxhimi
- Dokumentin për Vlerësimin e Rreziqeve si dhe Planin e Menaxhimit të Rreziqeve
- Objektivat e Bordit dhe Komiteteve Aktive
- Raportet e Zyrave Rregullative për shërbimet përkatëse (ZRRE,ZRRUK,ARH,ARKEP) ku paraqiten indikatorët operativ te arritur nga NP përkatëse , dhe shikuar ne relacion me caqet nga plani i biznesit dhe indikatorët e paraqitura ne raportet vjetore të këtyre ndërmarrjeve.

Mbledhja e dokumenteve më lartë është bërë në mënyrë elektronike nga ueb-faqja e NJPMNP, ueb-faqet e ndërmarrjeve respektive, ueb faqet e zyrave rregullative si dhe në mënyrë të drejtpërdrejt nga NJPMNP dhe Ndërmarrja Publike Qendrore pas kërkesës së stafit të kompanisë MCI.

Ndërmarrjet e Vlerësuara

Vlerësimi i performancës së NP-ve dhe efektshmërisë së Bordeve është bërë në ndërmarrjet publike qendrore më poshtë, në kompanitë rajonale të ujitjes dhe në kompanitë rajonale të ujësjellësit dhe atë:

Ndërmarrjet Publike Qendrore

Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a.
Posta e Kosovës sh.a.
Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. (PTK)
Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a. (KOSTT)
HK Trainkos sh.a.
Infrakos sh.a.
ANP - Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a.

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.
NPH Ibër-Lepenc sh.a.

Kompanitë Rajonale të Ujitjes

Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë sh.a., Pejë
Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini sh.a., Gjakovë

Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit

Kompania e Ujësjellësit Rajonal Prishtina sh.a., Prishtinë
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidrodrini, Pejë
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a., Prizren
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica sh.a., Mitrovicë
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava sh.a., Gjilan
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi sh.a., Gjakovë

Vlerësimi Përmbledhës

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje e vlerësimeve për secilën kompani ndaras dhe atë vlerësimin e përgjithshëm për shtatëmbëdhjetë kompanitë e vlerësuara.

1. Vlerësimi për secilën ndërmarrje	<i>Vlerësimi i Përgjithshëm</i>
Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a.	3.10
Posta e Kosovës sh.a.	2.87
Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. (PTK)	2.95
Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a. (KOSTT)	3.67
HK Trainkos sh.a.	3.06
Infrakos sh.a	3.22
ANP - Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a.	2.93
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.	3.20
NPH Ibër-Lepenc sh.a.	2.95
Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë sh.a., Pejë	2.58
Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini sh.a., Gjakovë	3.01
Kompania e Ujësjetës Rajonal Prishtina sh.a., Prishtinë	3.06
Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidrodrini, Pejë	3.22
Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.a., Prizren	2.95
Kompania Rajonale e Ujësjetës Mitrovica sh.a., Mitrovicë	2.65
Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidromorava sh.a., Gjilan	3.37
Kompania Rajonale e Ujësjetës Radoniqi sh.a., Gjakovë	3.07

Bazuar në të dhënat nga tabela më lartë vërehet se kompania me performancën dhe vlerësimin më të lartë është Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a. (KOSTT) me vlerësimin 3.67 nga vlerësimi maksimal që është 5.0, ndërsa kompania që ka performancën apo vlerësimin më të ulët është Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë sh.a. në Pejë me vlerësimin 2.58.

Nga tetë kriteret e vlerësimit të përcaktuar në këtë proces gjatë vlerësimit defektet më të mëdha janë vërejtur në kriteret në vijim dhe atë: kriteri 2 - Zhvillimi dhe performanca e KE-së, kriteri 4 - Shkalla e përthithjes së fondeve dhe kriteri 5 - Performanca e Bordit. Prandaj, ndërmarrjet e vlerësuar duhet të koncentrohen në përmirësimin e të gjitha kriterëve por me fokus të veçantë në kriteret e lartpërmenduar.

Vlerësimi i performancës së NP-ve Qendrore dhe Efektshmërisë së Bordeve të Drejtorëve

Në vijim do të paraqesim vlerësimin e performancës së secilës NP qendrore dhe Efektshmërisë së Bordeve të Drejtorëve konform kriterëve të vlerësimit të definuar më lartë.

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e Bordit nga tabela më poshtë është bërë me dt. 22.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Berat Rukiqi	19.09.2013	19.09.2016
Pranvera Dobruna	19.09.2013	19.09.2016
Enver Muli	19.09.2013	19.09.2016
Haki Mjekiqi	19.09.2013	19.09.2016
Burim Leci	19.09.2013	19.09.2016
Ranko Makiq	19.09.2013	19.09.2016

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a dhe efektshmërisë së Bordit. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kriterë të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kriterë të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	4.0
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.2
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.9
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	3.4
5	Performanca e Bordit	3.0
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	2.5
7	Komitetet e Bordit	3.5
8	Mbledhjet e Bordit	3.0
Vlerësimi i përgjithshëm		3.1

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kriterëve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e Bordit në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kriterë të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Planit Afarist. Bordi në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 30.10.2014, ka aprovuar Planin Afarist për vitin 2015, në të cilën është integruar edhe Misioni dhe Vizioni i kompanisë.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 30.10.2014, në kuadër të Planit Afarist për vitin 2015. Plani afarist nuk është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Vlen të ceket fakti se Bordi ka krijuar Komitetin për Çështje Strategjike që është në funksion të hartimit të planeve strategjike të kompanisë, sikurse Draft Strategjia e Energjisë 2013-2022,

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Bordi ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. Bordi gjatë vitit 2014 ka aprovuar Kodin e Punësimit (i ndryshuar dhe plotësuar), Kodin Disiplinor, Kodin për siguri në punë (i ndryshuar dhe plotësuar) Rregulloren për udhëtime zyrtare, Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit.

Politika mbi Çështjet e Financave: Bordi me dt. 20.03.2014 ka aprovuar rregulloren – Procesi i buxhetimit dhe kontrollimit të shpenzimeve në KEK.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Bordi ka krijuar Komitetin për Mjedis dhe Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave, që shqyrton projektet e kompanisë nga ana mjedisore dhe përgjegjësia sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: Bordi ka aprovuar Planin Buxhetor me dt. 30.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: Në vitin 2014 nuk është bërë ndonjë ndryshim në strukturat kryesore udhëheqëse të ekzekutivit të kompanisë. Drejtori Menaxhues aktual është zgjedhur para se të emërohen Drejtorët aktual të Bordi, dhe se i njëjti është zgjedhur në vitin 2009.

Përshkrimi i punës së KE-së: Bordi ka aprovuar përshkrimin e vendit të punës të KE të kompanisë.

Performanca e KE-së: Me dt. 28.05.2015, Bordi ka marr vendimin – Miratimi i performancës së zyrtarëve për vitin 2014, ku është bërë vlerësimi i performancës së zyrtarëve kryesor të kompanisë, duke përfshirë edhe performancën e Drejtorit Menaxhues. Vlerësimi i performancës është bazuar në caqet e performancës dhe arritshmëria e të njëjtave nga ana e Drejtorit Menaxhues. Vlerësimi nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të Drejtorit Menaxhues që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në çdo mbledhje të bordit përmes raportit të Drejtorit Menaxhues dhe raportit të Drejtorit Financiar të kompanisë.

Raportet tre mujore: Bordi i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, Bordi e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 16.03.2015. Në përgjithësi realizimi i prodhimit të qymyrit tregon 97.42% në krahasim me buxhetin e rishikuar derisa me buxhetin fillestar realizimi është 90.05%. Mosrealizimi i prodhimit të qymyrit në Sibovc jugperëndim shpjegohet me rastin e fatkeqësisë në repartin e elektrolizës në TC Kosova A. Zhvendosja e djerrinës tregon një realizim prej 87.92% në krahasim me buxhetin e rishikuar dhe 83.27 me atë fillestar. Nëse merren parasysh telashet që kane përcjell vitin 2014, mund të themi se kemi një performancë solide të korporatës. Në krahasim me vitin 2013, në të gjithë treguesit financiar dhe operativ (duke përfshirë edhe treguesit e gjenerimit të energjisë elektrike) kemi ngecje apo realizim me të dobët, mirëpo kur marrim parasysh se viti 2013 ishte viti me treguesit më të mire që nga paslufta atëherë mund të themi se rezultatet financiare dhe afariste në vitin 2014 janë të kënaqshme.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Bordi me dt. 20.03.2014 ka miratuar rregulloren për buxhetim dhe kontrollim të shpenzimeve.

Vlerësimi i Aseteve: Në shkurt të vitit 2014, Bordi ka bërë miratimin e Elaboratit për Regjistrimin e Pasurisë për vitin 2013. Nuk është bërë vlerësimi i asetëve për vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 30.05.2014, Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013. Opinioni i AJ është se pasqyrat financiare janë mbajtur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Si çështje të theksuara auditori ka prezantuar kërkesat ambientale dhe për dekomisionim, si dhe kërkesën për mbështetje afatgjate nga Aksionari për kredi, kthimin e atyre të vjetra si dhe të tarifave të përcaktuara nga auditori.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin afarist 2015. Sidoqoftë, nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e Bordit: Dy nga Drejtorët e Bordit (BR&RM) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i Bordit: Bordi ka qenë përgjegjës për planin e aktiviteteve për organizmin e konferencës së donatorëve. Komiteti për Çështje Strategjike ka ndërmarr aktivitete të ndryshme për krijimin e projekteve për takim me donatorët. Bordi angazhohet të paktën një herë në vit në planifikimin financiar afat-gjatë dhe atë me rastin e përpilimit të planit afarist.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e Bordit: Bordi ka caktuar objektivat që duhet arritur në vitin 2014 bazuar në planin afarist të kompanisë dhe se janë caktuar dy objektiva me peshën 50% secila. Objektivat e përcaktuara nga ana e Bordit janë: objektivi 1 - arritja e performancës pozitive të korporatës, duke operuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe në pajtueshmëri me praktikat etike të biznesit dhe objektivi 2 - pjesëmarrja aktive e anëtarëve të Bordit në qeverisjen e mirë të korporatës, monitorimin e menaxhmentit dhe udhëheqjen strategjike të sajë. Dy objektivat në fjalë i kanë pasur edhe një numër të caktuar të nën-objektivave.

Vetëvlerësimi: Bordi nuk e ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 konform formularit të ofruar / krijuar nga NJPMNP. Sidoqoftë, Bordi me dt. 30.03.2015 ka bërë vlerësimin e performancës së të gjithë Drejtorëve të Bordit bazuar në objektiva e lartcekura si dhe nën-objektivave të përcaktuara.

Kompensimet: Bordi ka përditësuar Deklaratën për politikën e kompensimit të drejtorëve me dt. 27.06.2014. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet me nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e Bordit dhe në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit, nuk është evidentuar se gjatë vitit 2014 ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP. Bordi ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Sidoqoftë, nuk i është dorëzuar paraprakisht NJPMNP agjenda e mbledhjeve të Bordit si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet në mënyrë të shkruar siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD nuk e ka bërë konfirmimin për vitin 2014 se asnjë Drejtor i Bordit nuk ka konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me Komitetet e Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014 Bordi ka pasur pesë Komitetet aktive dhe atë: Komiteti për Staf dhe Performancë, Komiteti për Çështje Strategjike, Komiteti Ad Hoc për Avarinë në TC A, Komiteti për Çështjen e Sigurimit Fizik dhe Komiteti për Mjedis dhe Përgjegjësi Sociale.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Në vitin 2014, Komisioni i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur trembëdhjetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur kamë raportuar komitetet para Bordit, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të tyre. Sidoqoftë,

komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Të gjitha komitetet janë të përbërë nga të paktën tre anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: Bordi në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. Bordi në vitin 2014 ka mbajtur gjashtëmbëdhjetë mbledhje. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuoromit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Avantazhet dhe disavantazhet e të gjitha çështjeve madhore janë të parapara në planin afarist dhe hapat që duhet ndërmarr për shfrytëzimin e të njëjtave në favor të kompanisë.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha janë të firmosura nga Kryesuesi i Bordit dhe Sekretari i Korporatës, por procesverbalet nuk janë dërguar me kohë te NJPMNP ashtu siq kërkohet në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Në vlerësimin e performancës së Drejtorit Menaxhues të integrohen kriteret e përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Vlerësimi i performancës së Drejtorit Menaxhues të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal të Drejtorit Menaxhues duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të gjithë Drejtorët e Bordit duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të bëhet vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit në bazë të kriterëve dhe formularit të caktuar nga ana e NJPMNP. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak si dhe duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen.
- Agjenda e mbledhjeve të Bordit si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet t'i dorëzohen paraprakisht NJPMNP.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë me përfundimin e vitit dhe fillimin e vitit tjetër. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

Posta e Kosovës sh.a

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e Bordit nga tabela më poshtë është bërë me dt. 24.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Halit Isufi	21.03.2013	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Aziz Pacolli	21.03.2013	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Branislav Nikoliq	21.03.2013	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Në vitin 2014 Bordi ka qenë i pasuruar edhe nga një Drejtor (ZI) i cili ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksioneve të tij në kuadër të Bordit. Si rrjedhojë e dorëheqjes së bërë nuk është arritur të integrohet performanca e tij në vlerësimin e performancës dhe efektshmërisë së Bordit.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së kompanisë dhe efektshmërisë së Bordit. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kriterë të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kriterë të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	2.7
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.7
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	1.8
5	Performanca e Bordit	1.8
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	3.1
7	Komitetet e Bordit	3.6
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		2.87

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e Bordit në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kriterë të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. Bordi në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 07.11.2014, ka aprovuar Planin e Biznetit 2015-2017, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Aprovimi i planit të biznesit është bërë jashtë afateve të parapara në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Gjithashtu, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2014-2016 dhe 2015-2017.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 07.11.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Bordi ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. Bordi gjatë vitit 2014 ka aprovuar Kodin e Mirësjelljes së Punonjësve të Postës së Kosovës, Rregullorja për rregullimin e marrëdhënies së punës për punonjësit e Postës së Kosovës. Në vitin 2013, Bordi ka aprovuar rregulloret në vijim: Rregullore për sistematizimin e Vendeve të Punës, Rregulloren për staf dhe shpërblime të punonjësve.

Politika mbi Çështjet e Financave: Ndërmarrja ka rregullore të ndryshme për çështje të financave dhe atë: Udhëzim për kontabilitet dhe financa; udhëzim për arkën qendrore; udhëzim për kontroll të befasishëm financiar; udhëzim për

barazime ditore; etj. Sidoqoftë, ndërmarrja, nuk ka rregullore të veçantë mbi nivelin e aprovimeve të shpenzimeve nga menaxhmenti.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Bordi nuk ka miratuar ndonjë politikë të veçantë mbi menaxhimin e reziqeve dhe përgjegjësi sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: Bordi ka aprovuar Planin e Buxhetit në kuadër të Planit të Biznesit 2015-2017 me dt. 07.11.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: KE aktual është zgjedhur pas publikimit të konkursit ekstern dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit në vitin 2012.

Përshkrimi i punës së KE-së: Detyrat dhe përgjegjësitë e KE-së kanë qenë të përshkruara në konkursin e përzgjedhjes, në bazë të vendimit të dt. 25.07.2012 dhe poashtu janë të përshkruara në Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës të PK-së, të miratuar në mbledhjen me dt. 30.08.2013.

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin me datën 16.06.2014, Bordi ka rishqyrtuar performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën Bordi e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me Bordin, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe aseteteve të kompanisë. Gjithashtu, vlerësimi nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të Drejtorit Menaxhues që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në baza mujore.

Raportet tre mujore: Bordi i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, Bordi e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 04.03.2015. Gjatë vitit 2014, kompania ka realizuar 9,992,105€ të hyra derisa të planifikuara kanë qenë 10,471,538, që tregon realizim prej 95.42%. Të hyrat nga shërbimet postare tregojnë mosrealizim prej rreth 13%. Poashtu të hyrat nga shërbimet financiare jobankare, posta ndërkombëtare dhe posta hibride kanë treguar ngritje në këtë vit. Dhe atë posta ndërkombëtare me 27%, shërbimet financiare jobankare me 14% dhe posta hibride me 332%. Rritja në kategorinë e postes hibride është si rezultat i regjistrimit të shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë në këtë kategori (me parë të njëjtat janë regjistruar në kategorinë e konsumatorëve të mëdhenj). Të hyrat nga konsumatorët e mëdhenj tregojnë rënie prej rreth 11%. Të hyrat nga filatelia tregojnë ngritje prej 17%. Të hyrat nga shitja e produkteve të PTK-se ka treguar rënie prej rreth 18%. Shpenzimet totale të kompanisë në krahasim me planifikimin tregojnë rënie prej rreth 10%. Fitimi tregon rezultat negativ prej mbi 4 milion Euro që është më i ulët se planifikimi prej rreth 21% si rezultat i shpenzimeve me të ulëta. Vëllimi fizik i dërgesave postare tregon tejkalim në krahasim me planifikimin në të gjitha kategoritë (letërdërgesa 10%, koliposta 8%, EMS 72% dhe thasët "M" 121%). Nga treguesit operativ dhe financiar mund të konkludojmë se kompania në vitin 2014 ka performancë të pranueshme sidomos në kategorinë e lidhjes së kontratave me institucionet qendrore dhe lokale (ministritë, agjencionet, komunat, etj).

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Çështjet e shpenzimeve për mëditje, udhëtime dhe dieta, dhe shpenzime tjera të përfaqësimit janë të rregulluara në Rregulloren për udhëtime zyrtare për punonjësit të miratuar në vitin 2013 nga Komiteti për Staf dhe Shpërblime.

Vlerësimi i Aseteve: Me dt. 02.06.2014, Bordi ka miratuar raportin mbi regjistrimin e mjeteve themelore të Postës së Kosovës për vitin 2013. Nuk është bërë vlerësimi i aseteteve për vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 25.04.2014, Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituar për vitin 2013. Opinioni i AJ është se pasqyrat financiare paraqesin drejtë pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin e biznesit 2015-2017. Sidoqoftë, nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e Bordit: Dy nga Drejtorët e Bordit (HI&BN) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i Bordit: Bordi nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar për të thithur financime nga BE. Në dokumentet e shqyrtuara, në asnjë prej tyre nuk vërehet se Bordi luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër. Bordi angazhohet të paktën një herë në vit në planifikimin financiar afat-gjatë dhe atë me rastin e përpilimit të biznes planit. Me rastin e përpilimit të biznes planit, në kuadër të planit të investimeve kapitale Bordi nuk ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga qeveria dhe donatorë të jashtëm.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e Bordit: Bordi nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të Bordit në realizimin e atyre objektiveve.

Vetëvlerësimi: Bordi ka bërë raportin e vetëvlerësimit, aprovuar me dt. 18.06.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: Bordi ka përditësuar Rregulloren për staf dhe shpërblime të aprovuar me dt. 31.01.2014. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet me nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e Bordit dhe në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit, në vitin 2014 nuk është evidentuar ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP. Bordi ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD nuk e ka bërë konfirmimin për vitin 2014 se asnjë Drejtor i Bordit nuk ka konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, Bordi ka pasur gjashtë Komitetet aktive dhe atë: Komiteti për Staf & Shpërblime, Komiteti i Financave, Komiteti për Hulumtime & Teknologji, Komiteti i Përkohshëm për Sistemin e Automatizimit të Sporteve, Komiteti i Përkohshëm Për Postën Hibride & Qendrën Transite dhe Komiteti për Transaksione Bankare. Vlen të ceket se Komiteti për Sistemin e Automatizimit të Sporteve, Komiteti për Postën Hibride & Qendrën Transite si dhe Komiteti për Transaksione Bankare kanë qenë aktive deri në muajin shtator.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Në vitin 2014, Komisioni i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur dymbëdhjetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para Bordit, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të tyre. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Të gjitha komitetet janë të përbërë nga të paktën tre anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: Bordi në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. Bordi në vitin 2014 ka mbajtur katërbëdhjetë mbledhje. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Avantazhet dhe disavantazhet e të gjitha çështjeve madhore janë të parapara në planin e biznesit dhe hapat që duhet ndërmarr për shfrytëzimin e të njëjtave në favor të organizatës.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha janë të firmosura nga Kryesuesi i Bordit dhe Sekretari I Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraparak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave dhe nivelin e aprovimit të shpenzimeve nga menaxhmenti, rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të gjithë drejtorët e Bordit duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj të gjitha objektivat që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Të bëhet vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit në bazë të kriterëve dhe formularit të caktuar nga ana e NJPMNP. Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraparak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraparak.

- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e Bordit nga tabela më poshtë është bërë me dt. 25.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Rexhë Gjonbalaj	27.12.2013	27.12.2016
Gani Sylja	27.12.2013	27.12.2016
Afrim Loku	27.12.2013	27.12.2016
Naim Hyseni	27.12.2013	27.12.2016
Suzana Andelkovic	27.12.2013	27.12.2016
Bislim Zogaj	27.12.2013	27.12.2016

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës sh.a dhe efekshmërisë së Bordit. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kriteret e ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kriteret e ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.7
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.8
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	2.4
5	Performanca e Bordit	2.0
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	2.5
7	Komitetet e Bordit	3.3
8	Mbledhjet e Bordit	3.8
Vlerësimi i përgjithshëm		2.95

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kriteret e ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 29.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2019, në të cilën është integruar edhe Plani Strategjik i Marketingut. Sidoqoftë, plani strategjik i marketingut ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2015-2019 dhe 2014-2019.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 29.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2019. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë pesë vjeçare më gjatë se është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Bordi ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. Bordi ka aprovuar politikat në vijim dhe atë: Kodi i mirësjelljes së punonjësve dhe procedurat disiplinore, Politika e rekrutimit dhe seleksionimit, Politika mbi etikën, Politika mbi evidencën në punë, Politika mbi menaxhimin e performancës, Politika mbi shpërbllimin e punonjësve, etj.

Politika mbi Çështjet e Financave: Ndërmarrja ka rregulluar çështje të financave përmes dokumentit – Matrica e vendimit të korrigjuar për autorizimet në PTK, në të cilën është definuar niveli i shpenzimeve dhe financave nga strukturat kompetente brenda kompanisë.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: BD nuk ka miratuar ndonjë politikë të veçantë mbi menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësi sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: Bordi ka aprovuar Planin e Buxhetit në kuadër të Planit të Biznesit 2015-2019 me dt. 29.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: Me dt. 01.08.2014, për shkak të performancës së dobët ka shkarkuar KE-në (EQ). Me rastin e shkarkimit ka emëruar një ushtrues detyre dhe pas publikimit të konkursit ekstern dhe pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit në shkurt të vitit 2015 është zgjedhur KE i kompanisë.

Përshkrimi i punës së KE-së: BD ka aprovuar përshkrimin e vendit të punës të KE të kompanisë.

Performanca e KE-së: Vendimin mbi shkarkimin e KE-së në vitin 2014, Bordi e ka marrë bazuar në performancën e kompanisë dhe të KE-së. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën Bordi e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me Bordin, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Vlerësimi i KE-së nuk është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore, por në baza tre mujore.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 13.03.2015. Sipas ARKEP, TM4 i vitit 2014, Vala përbën rreth 53.4% të shfrytëzuesve të telefonisë mobile dhe 58.6% të të hyrave në treg. Po sipas këtij raporti, Telefonia Fikse përbën 82.7% të të hyrave nga zëri si dhe 17.7% të përdoruesve të internetit. Në krahasim me vitin 2013, të hyrat me 2014 janë për 22% me të ulëta. Margjina bruto e realizuar në krahasim me planifikimin tregon ndryshim negativ prej 0.6%, si rezultat i të hyrave me të ulëta të realizuara (sidomos brenda NJB Vala). EBITDA në krahasim me planifikimin tregon rënie prej rreth 5%. Në mungesë të informatave konkrete për të hyrat dhe konsumatorët (pasi që nuk janë publikuar pasqyrat financiare të audituara), dhe me informatat që merren edhe nga ARKEP mund të konkludojmë se PTK ka treguar një trend të rënies, që vërehet në shërbimet e zërit (respektivisht Vala-s) që janë përcjellë edhe me rënie të ndjeshme të numrit të konsumatorëve. Vlen të merret parasysh fakti se gjatë vitit 2014 (dhe fillim vitin 2015) PTK ishte në vllugun me të madh të investimeve kapitale (platforma 3G dhe 4G/LTE).

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Çështjet e shpenzimeve për mëditje, udhëtime dhe dieta, dhe shpenzime tjera të përfaqësimit janë të rregulluara në Politikën mbi udhëtimet zyrtare aprovuar në vitin 2006 si dhe më Udhëzimin mbi aplikimin e orëve shtesë aprovuar në vitin 2014.

Vlerësimi i Aseteve: Me dt. 01.04.2014, Bordi ka miratuar raportin e mjeteve themelore për vitin 2013 për gatitur nga Komisioni i Regjistrimit. Nuk është bërë vlerësimi i asetëve për vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 23.05.2014, Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituar për vitin 2013. Opinioni i AJ është i pakualifikuar dhe se pasqyrat financiare paraqesin drejtë pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin e biznesit 2015-2019. Sidoqoftë, nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Njohuritë e Bordit: Dy nga Drejtorët e Bordit (SA&AL) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i Bordit: Bordi nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar për të thithur financime nga BE. Në dokumentet e shqyrtuara, në asnjë prej tyre nuk vërehet se Bordi luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër. Bordi angazhohet të paktën një herë në vit në planifikimin financiar afat-gjatë dhe atë me rastin e përpilimit të biznes planit. Me rastin e përpilimit të biznes planit, në kuadër të planit të investimeve kapitale Bordi nuk ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga qeveria dhe donatorë të jashtëm.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Objektivat e Bordit: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: Bordi ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 me dt. 21.05.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP-së që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD ka përditësuar Rregulloren për staf dhe shpërblime të aprovuar me dt. 05.02.2014. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet me nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD, në vitin 2014 nuk është evidentuar se Bordi ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP. Bordi nuk i ka dorëzuar paraprakisht NJPMNP agjenda e mbledhjeve të Bordit si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet në mënyrë të shkruar siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD nuk e ka bërë konfirmimin për vitin 2014 se asnjë Drejtor i Bordit nuk ka konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, Bordi ka pasur pesë Komitetet aktive dhe atë: Komiteti për Staf dhe Shpërblime, Komiteti për Financa & Rishikim Rreziku, Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji, Komiteti për Përcjelljen e Produkteve dhe Marketing, Komiteti për Përcjelljen e Projekteve Kapitale.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Në vitin 2014, Komisioni i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur shtatëmbëdhjetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuara në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Të gjitha komitetet janë të përbërë nga të paktën tre anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: Bordi në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur pesëmbëdhjetë mbledhje. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Avantazhet dhe disavantazhet e të gjitha çështjeve madhore janë të parapara në planin e biznesit dhe hapat që duhet ndërmarr për shfrytëzimin e të njëjtave në favor të organizatës.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha janë të firmosura nga Kryesuesi i Bordit dhe Sekretari I Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të gjithë Drejtorët e Bordit duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Agjenda e mbledhjeve të Bordit si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet t'i dorëzohen paraprakisht NJPMNP.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektivi të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 24.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ramadan Paçarada	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Fatos Ukaj	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Lutfi Maxhuni	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Nazmi Mikullovc	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Në vitin 2014, Bordi ka qenë i pasuruar edhe nga një Drejtor i BD (FD) i cili për arsye personale ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksioneve të tij në kuadër të BD. Si rezultat i dorëheqjes së dhënë nuk është arritur të integrohet performanca e tij në vlerësimin e performancës së KOSTT dhe efektshmërisë së Bordit.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KOSTT-it dhe efektshmërisë së Bordit. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	4.0
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.7
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.7
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	3.6
5	Performanca e Bordit	2.8
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.4
7	Komitetet e Bordit	3.8
8	Mbledhjet e Bordit	4.4
Vlerësimi i përgjithshëm		3.67

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 30.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2014 dhe 2015, por me ndryshime nga i vitit 2013.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 30.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015. Gjithashtu, plani i biznesit nuk është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Bordi ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. Bordi në vitin 2014 ka aprovuar Amendamentin e Kodit Disiplinor të KOSTT. Ndërsa, Bordi në vitet e mëhershme miratoi ndryshimet dhe plotësimet në Politikën e kompensimit për stimulimin e efektshmërisë në bazë të performancës për Bordin dhe zyrtarët e lartë në ndryshimin dhe plotësimin e Manualit të punëtorëve, Ndryshimin dhe plotësimin e politikës së pushimeve, Ndryshimin dhe plotësimin e politikës së orarit të punës, Ndryshimet dhe plotësimet e Politikës në rekrutim dhe selektim.

Politika mbi Çështjet e Financave: Çështjet e financave janë të rregulluara në Politikën mbi nivelin e Autorizimit në KOSTT sh.a.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: BD ka aprovuar Politikën mbi mbrojtjen e mjedisit Aprovimi i Buxhetit Vjetor: Bordi ka aprovuar Planin e Buxhetit për vitin 2014 në mbledhjen e dt. 30.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: Në bazë të vendimit të BD nr. 130822-II/6 të dt. 22.08.2013, me dt. 04.09.2013 është bërë shpallja publike për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT në harmoni me ligjin dhe politikën e KOSTT. Me vendimin e BD është themeluar paneli intervistues i cili i ka zgjedhur KE-në dt. 09.10.2013. .

Përshkrimi i punës së KE-së: Bordi ka aprovuar përshkrimin e vendit të punës të KE-së.

Performanca e KE-së: BD ka bërë Vlerësimin e Performancës Individuale të KE-së për Periudhën Janar – Dhjetor 2014 ku janë të përfshira kalkulimet e performancës: Aksionet e planifikuara nga Plani Operativ kundrejt atyre të realizuara, Aksionet e planifikuara nga Plani Kreativ kundrejt atyre të realizuara, Vlerësimi i shkathtësive menaxheriale, Vlerësimi i të arriturave zhvillimore. Poashtu me dt. 27.01.2014 është bërë Vlerësimi i performancës menaxheriale, ku në bazë të dhjetë kritereve Kryeshefi Ekzekutiv është vlerësuar me mesatare 9.78. Kriteret e aplikuar për vlerësimin e KE-së nuk janë të njëjta me kriteret e përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kosteve të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore, por bëhen çdo tre muaj.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë në Raportin Vjetor për vitin 2014, që është aprovuar me dt. 05.03.2015. TC Kosova A ka treguar performancë të lakmueshme pasiçë ka arritur të prodhojë 15.07% me shume se plani derisa TC Kosova B ka treguar performancë negative me 6.87%. Hidrocentrali i Ujmanit dhe ai i Lumbardhit kanë treguar tejkalim në prodhim dhe atë 23% HC Ujmani dhe 21% HC Lumbardhi. Në përgjithësi prodhimi tregon realizim prej 99.4% që llogaritet si i akceptueshem. Eksporti ka treguar tejkalim nga plani për rreth 52%, derisa importi tejkalon për 7.8%. Poashtu humbjet në transmision tregojnë rënie në krahasim me planifikimin prej rreth 4.95%. Te hyrat e realizuara tregojnë realizim prej rreth 98% në krahasim me planifikimin. Shpenzimet poashtu tregojnë mosrealizim prej rreth 5%, që rezultojnë neto prej rreth 8% tejkalim në krahasim me planifikimin për 2014. Në përgjithësi mund të konkludohet se KOST ka treguar performancë të mirë pasiçë prodhimi është në nivel të dëshirueshëm që vërehet edhe me eksportin e tejkaluar (për dallim të tejkalimit të importit), si dhe rënia e humbjeve dhe shpenzimeve operative.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, diëta të punonjësve dhe marketing: BD ka aprovuar politikën mbi udhëtimet zyrtare në maj të vitit 2010.

Vlerësimi i Aseteve: BD ka aprovuar raportin e Komisionit për regjistrimin e pasurisë të KOSTT-it për vitin 2014, që është elaborat i regjistrimit të asetëve.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 17.04.2014, BD ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të Audituar për vitin 2013 dhe letrës për menaxhmentin dërguar nga Auditori i Jashtëm. Raporti i auditorit të jashtëm nuk përmban asnjë kualifikim dhe se pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në SWOT analizën e integruar në Planin e Biznesit për vitin 2015. Nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve. Sidoqoftë, BD i ka propozuar menaxhmentit që gjatë vitit 2015 të hartoj politikën mbi menaxhimin e rrezikut.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e BD: Dy nga Drejtorët e BD (FU&LM) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronë shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: Strategjia dhe projektet që duhet të kryhen janë të definuar në dokumentin plani zhvillimor i transmissioinit 2014-2023 dhe Planit Investiv 2013-2017. BD luan rol aktiv në përcjelljen e të gjitha aktiviteteve të ndërmarra nga menaxhmenti në përpjekjet dhe aktivitetet e zhvilluara për të thithur fondet nga BE. BD angazhohet të paktën një herë në vit në planifikimin financiar afat-gjatë dhe atë në hartimin e biznes planit. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Buxheti i Kosovës, donatorët apo nga buxheti vetjak i kompanisë. Gjithashtu, në vitin 2014 është lidhur marrëveshja për kredi me BERZH.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete për BD dhe Komitetet e BD, që është bërë në Planin Vjetor të Aktiviteteve aprovuar me dt. 25.01.2013.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit të Drejtorëve të BD për vitin 2014 me datën 23.04.2015. Nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal dhe nuk përfundon procesi i vetë-vlerësimit me një plan konkret për të përmirësuar vlerat e kompanisë.

Kompensimet: BD ka përditësuar Deklaratën për Politikën e Kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KOSTT-it me dt. 20.05.2014. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet me nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marrë ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Trajnimi: Dy nga Drejtorët e BD (FU&LM) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronë shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD me dt. 02.03.2015 ka konfirmuar se gjatë vitit 2014 asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, Bordi ka ngritur pesë komitete të përkohshme dhe atë: Komiteti për investime Kapitale (deri me 31.06.2014), Komiteti për Operim (deri me 31.06.2014), Komiteti për Legjislacion & Përcjelljen e Kontesteve Ligjore (deri me 31.06.2014), Komiteti për Staf & Shpërblime dhe Komiteti për Hulumtim & Teknologji.

Raportimet e Komitetit të Auditimit: Në vitin 2014, Komiteti i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. BD me dt. 25.01.2014 ka aprovuar Planin Vjetor të Aktiviteteve për Bordin dhe Komisionin e Auditimit për vitin 2014 bazuar në Ligjin mbi NP, Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare dhe aktet nën-ligjore të kompanisë.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit është kompletuar me tre anëtar nga dt. 29.01.2014, ndërsa Komiteti për Hulumtim & Teknologji nga dt. 14.11.2014 me dorëheqjen e njërit Drejtor të Bordit ka mbetur me vetëm dy anëtar. Të gjitha komitetet tjera janë të përbërë nga të paktën tre anëtarë ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur dymbëdhjetë mbledhje. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuoromit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit për vitin 2015, të miratuar me dt. 30.10.2014, BD ka bërë analizë të sidave përmes një analizë SWOT (Përparësitë – Strength, Mangësitë – Weaknesses, Mundësitë – Opportunities, Rreziqet – Threats).

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Në vlerësimin e performancës së KE-së duhet të integrohen kriteret e përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe objektivat që janë duke u vlerësuar. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak. Kriteret e vlerësuara me pikët maksimale duhet të argumentohen me komente dhe shifra që mbështet vlerësimin e bërë.
- Caktimi i objektiveve të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të gjithë Drejtorët e Bordit duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektivi të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal (jo vetëm për Komisionin e Auditimit) dhe të bëhet vlerësimi i objektiveve në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

HK Trainkos sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 17.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Heset Cakolli	01.09.2011	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Labinot Halilaj	01.09.2011	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Shkumbin Hyseni	01.09.2011	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Në vitin 2014, Bordi i HK Trainkos ka qenë i pasuruar edhe nga një Drejtor i BD (HI) i cili ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksioneve të tij në kuadër të BD. Si rrjedhojë e dorëheqjes së bërë nuk është arritur të integrohet performanca e tij në vlerësimin e performancës së kompanisë dhe efektshmërisë së Bordeve.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së HK Trainkos dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së HK Trainkos sh.a., janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	2.8
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	2.9
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	1.7
5	Performanca e Bordit	2.4
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.7
7	Komitetet e Bordit	3.5
8	Mbledhjet e Bordit	4.4
Vlerësimi i përgjithshëm		3.06

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 30.10.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në tre biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2013, 2014 dhe 2015.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 30.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015, dhe se të njëjtat janë aprovuar brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për NP si dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Plani i biznesit është bërë në baza vjetore dhe jo në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD ka rishikuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. BD gjatë vitit 2014 ka rishikuar politikat më poshtë që rregullojnë çështjet e punësimit dhe atë: Rregullore e Marrëdhënies së punës, Rregullore mbi paga dhe kompensimet tjera ne Trainkos, Rregullore mbi përshkrimin e detyrave të punës, Udhëzimi mbi Përshkrimin e detyrave të Trainkos, Udhëzim mbi përshkrimin e Detyrave për Departamente dhe Zyra, Kategorizimi dhe Poentimi i Pagave. BD ka aprovuar edhe politika tjera që rregullojnë çështjet tjera mbi sigurinë në punë, skemën organizative, etj. Vlen të cekim faktin se të gjitha rregulloret më lartë si dhe disa rregullore tjera janë rishikuar nga ana e BD gjatë mbledhjes nr. 49.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: BD me dt. 14.11.2014 ka aprovuar Rregulloren e marrëdhënies së punës/Politika procedura e personelit, në të cilën në nenin 2 është paraparë dhe definuar ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit në marrëdhënien e punës. Sidoqoftë, nuk ka rregullore të veçantë mbi përgjegjësinë sociale. BD nuk ka aprovuar rregullore që mbulon menaxhimin e risqeve.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit për vitin 2015 në mbledhjen e dt. 30.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD ka ngritur proces të strukturuar dhe aktiv në përzgjedhjen e KE-së, dhe atë përmes institucionit të konkursit ekstern. Vendimi për zgjedhjen në KE-së është marr nga BD me dt. 27.09.2012. Sidoqoftë, nga dt. 31.12.2014 KE ka dhënë dorëheqje, dhe se BD ka ndërmarr hapat e menjëhershme me emërimin e ushtruesit të detyrës së KE-së, si dhe shpallur konkursin për KE.

Përshkrimi i punës së KE-së: Përshkrimi i KE-së është aprovuar nga BD dhe integruar në kuadër të dokumentit - Udhëzimi mbi Përshkrimin e detyrave të Trainkos, dt. 06.02.2012

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin BD rishqyrton në baza vjetore performancën e Menaxhmentit të Kompanisë, që bëhet për zyrtarët kryesor të Kompanisë. Nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Vlen të ceket fakti se në baza mujore dhe vjetore bëhen raportime mbi punën e KE-së, të njëjtat janë të koncentruar në afarizmin e përgjithshëm të kompanisë, dhe nuk janë të koncentruar në kompetencat e KE-së.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore, por të njëjtat rishikohen në baza tre mujore. Mungesa e raporteve operative mujore nuk është në përputhje me nenin 28.2 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 17.03.2015. Kompania gjatë vitit 2014 ka realizuar 837,829.54 ton transport te mallrave që ne krahasim me planifikimin për vitin 2014 kemi rënie për rreth 5%. Ne krahasim me vitin paraprak (2013) kemi rënie për rreth 164,628.3 apo rreth 16%. Qarkullimi i numrit të udhëtarëve në vitin 2014 në Raport me planifikimin tregon rënie prej rreth 8.16% dmth kemi numër më të ulët të udhëtarëve (4.69% ne krahasim me vitin e kaluar). Ne tregues financiar, respektivisht të hyra kemi tejkalim nga plani për vitin 2014 dhe atë me rreth 5.81%. Fitimi për vitin 2014 është 847,712.72 apo rreth 47%. Nga transporti i mallrave ne krahasim me planifikim është realizuar 97.84%. Trainkos gjatë vitit 2014 ka treguar rënie në të gjithë treguesit operativ dhe financiar dhe mund të themi se performance e TRAINKOS është nën planifikimin dhe nivelin e dëshiruar.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: Në mbledhjen e dt. 27.05.2013, Komiteti për Staf dhe Shpërblime ka miratuar propozimin për mëditje për personelin e trenit (makinistët, udhëheqësit e trenave, frenuesit, konduktorët, dhe punëtorët e sigurimit).

Vlerësimi i Aseteve: BD me vitin 2013 ka miratuar raportin e Komisionit për regjistrimin e Aseteve (sipas planit akcional). Nuk është bërë vlerësimi i asetëve për vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 21.03.2014, BD ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013. Ndërsa, në mbledhjen e përgjithshme

vjetore me Aksionarin të dt. 23.06.2014 është miratuar raporti i Auditorit për Pasqyrat financiare të Audituarra për vitin 2013. Në përjashtim të disa çështjeve të evidentuara lidhur me hapjen e llogarive për asetet fikse, inventaret dhe konfirmimet mbi arketueshmëritë, opinioni i auditorit është se pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në baza vjetore në kuadër të planit të biznesit, në pjesën e SWOT analizës. Sidoqoftë, risqet e integruara në SWOT analizë nuk janë të detajuara sa duhet si dhe nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Njohuritë e BD: Të gjithë drejtorët e BD kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: Nuk ka ndonjë përpjekje apo strategji për të thithur financime nga BE. Nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE. Në vitin 2013 BD ka rekomanduar menaxhmentin që të fillojë në hartimin e strategjisë së përgjithshme afat-mesme të investimeve dhe planifikimeve financiare të kompanisë. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk janë paraparë, Fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e objektivave të përcaktuara.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014, aprovuar me dt. 17.03.2015, që është mjaft i detajuar dhe i përgatitur shumë mirë. Nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: Me dt. 22.01.2014, BD ka marr vendim për përditësimin e politikës mbi shpërblimet. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Trajnimi: Të gjithë drejtorët e BD kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD ka konfirmuar me dt. 24.06.2015 se gjatë vitit 2014, asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014 kanë funksionuar në faza të ndryshme tetë Komitetet të BD dhe atë: Komisioni i Auditimit, Komiteti i Financave, Komiteti për Staf & Shpërblime, Komiteti për Projekte Kapitale, Komiteti për

Transportin e Udhëtarëve, Komiteti për Politikën e Sigurisë & Akteve tjera Normative. Pas riorganizimit të komiteteve nga dt. 30.07.2014 janë aktive katër komitete dhe atë Komisioni i Auditimit, Komiteti i Financave, Komiteti për Staf & Shpërblime dhe Komiteti për Projekte Kapitale.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i auditimit ka raportuar në lidhje me detyrat e kryera të paktën në baza tre-mujore dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Në vitin 2014 Komisioni i Auditimit i ka mbajtur njëmbëdhjetë takime.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Komitetet ad-hoc: BD ka ngritur Komitete ad-hoc dhe funksionimi i tyre ka qenë deri në realizimin e qëllimit për çka edhe janë krijuar, dhe se në vitin 2014 janë shpërbërë tre komitete.

Përbërja e Komiteteve: Nga dt. 22.10.2014, Komisioni i Auditimit ka funksionuar me vetëm dy anëtar pas dorëheqjes së njërit Drejtor nga BD dhe emërimit të Kryesuesit. Ndërsa, të gjitha komitetet janë të përbërë nga të paktë 3 anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur dymbëdhjetë mbledhje duke përfshirë edhe mbledhjen e përgjithshme me Aksionarin. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi i çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit të vitit 2015 BD ka bërë një analizë të kapaciteteve financiare, teknike, dhe të konkurrencës.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Plani i biznesit të bëhet në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.

- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të bëhet vlerësimi i aseteve të ndërmarrjes.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

Infrakos sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 17.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Hysen Fazliu	01.09.2011	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Halim Peci	01.09.2011	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Halil Kika	01.09.2011	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së Infrakos sh.a. dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kriterë të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kriterë të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.7
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.5
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.2
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	3.2
5	Performanca e Bordit	2.6
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.5
7	Komitetet e Bordit	3.3
8	Mbledhjet e Bordit	4.4
Vlerësimi i përgjithshëm		3.42

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kriterë të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në

mbledhjen e dt. 31.10.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në katër biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 31.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015. Gjithashtu, misioni dhe vizioni i kompanisë i përcaktuar në kuadër të planit të biznesit është bërë në baza vjetore dhe jo në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. BD gjatë vitit 2014 ja aprovuar rregulloret në vijim dhe atë: Rregulloren mbi pagat dhe kompensimet tjera, Rregulloren mbi sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës. Gjithashtu, BD ka aprovuar rregullore të ndryshme dhe atë: Rregulloren e marrëdhënies së punës, Rregulloren mbi menaxhimin e automjeteve zyrtare, Rregulloren mbi kushtet shëndetësore, etj.

Politika mbi Çështjet e Financave: BD ka të aprovuar dokumentin - Matrica e Autorizimeve në të cilën parashihen çështjet e financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Në rregulloren mbi marrëdhënien e punës janë të rregulluar mundësitë e barabarta për punësim. Nuk ka rregullore interne për përgjegjësi sociale dhe se këto çështje janë të mbuluara pjesërisht me akte eksterne dhe ligjet në fuqi.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit për vitin 2015 që është integruar në kuadër të planit të biznesit dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD ka ngritur proces të strukturuar dhe aktiv për zgjedhjen e KE-se dhe atë përmes konkursit ekstern. Në Janar të vitit 2014 KE-së i është vazhduar mandati edhe për një periudhë tre vjeçare.

Përshkrimi i punës së KE-së: Përshkrimi i vendit të punës të KE-së është i integruar në Rregulloren mbi sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës në Infrakos.

Performanca e KE-së: Bordi ka vlerësuar performancën e KE-së për vitin 2014 me dt. 30.04.2015 përmes dokumentit - Formulari i vlerësimit të kryerjes së punës. Vlerësimi i performancës së KE-së nuk është bërë konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në anët ku ka hapësirë për tu zhvilluar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore, por bëhen çdo tre muaj.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 13.03.2015. Të hyrat totale të Infrakos në krahasim me buxhetin tregojnë tejkalim prej 246,895.29, mirëpo krejt kjo fale kategorisë së të hyrave të shtyera (me vlere prej 840,902.5). Te hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit tregojnë variance negative me planifikimin dhe atë me - 189,207.27 apo 19.85 %. Poashtu edhe të hyrat nga qiraja tregojnë rënie prej 53,335.37 derisa vetëm të hyrat tjera tejkalojnë planifikimin dhe atë me 78,405,97 apo rreth 10.02%. Shpenzimet gjate vitit te InfraKoss tregojnë rënie prej rreth 13% ne krahasim me planifikimin për 2014. Nëse krahasohet realizimi i te hyrave (ne vlere prej 246,895.29 , 19.57% me te larta se planifikimi) dhe mosrealizimit te shpenzimeve te planifikuara me vlere prej 399,728.04, mund të konkludojmë se Infrakos ka arritur rezultat te mire afarist ne krahasim me planifikimin.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: Pjesërisht është e mbuluar në dokumentin – Matrica e Autorizimeve.

Vlerësimi i Aseteve: BD në vitin 2013, ka miratuar rekomandimin e Komisionit të Auditimit për shlyerjen nga libri kontabël regjistri i asetëve të dala nga Komisionit për regjistrimin e Asetëve i emëruar nga menaxhmenti i INFRAKOS-it. Bordi nuk e ka bërë vlerësimin e asetëve për vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin të dt. 23.06.2014 është aprovuar raporti i Auditorit për Pasqyrat financiare të Audituarat për vitin 2013 dhe letra dërguar menaxhmentit. Opinioni i Auditorit të Jashtëm është i pakualifikuar dhe se pasqyrat financiare, performanca financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhë të parasë janë kryer në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe SNA.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në Planin e Biznesit për vitin 2015 aprovuar me dt. 31.10.2014 dhe në të njëjtën janë të paraparë hapat e veprimit në menaxhimin e rreziqeve në fjalë.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e BD: Të gjithë Drejtorët e BD e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP, “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporatave.”

Angazhimi i BD: Nuk ka ndonjë përpjekje apo strategji për të thithur financime nga BE. Planifikimi financiar afatgjatë është i paraparë në kuadër të planit të biznesit dhe bëhet në baza vjetore. Bazuar në procesverbalet e mbledhjeve nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk janë paraparë, Fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete për BD dhe Komisionin e Auditimit. Objektivat e parapara në Planin e Biznesit janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 me dt. 01.06.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD ka përditësuar politikën mbi shpërblimet ku edhe është aprovuar Deklaratën për Politikën e Kompensimit për performancën e Bordit të Kompanisë.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP dhe nuk është evidentuar ndonjë vërejtje apo sugjerim nga NJPMNP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Trajnimi: Të gjithë Drejtorët e BD e kanë ndjekur trajnimin e thirrur nga NJPMNP, “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporatave.”

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD me dt. 18.06.2015 ka konfirmuar se asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, Bordi ka pasur dy Komitete aktive dhe atë: Komiteti për Staf dhe Shpërblime, Komiteti për Hulimtim e Teknologji dhe Siguri e Financa.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i Auditimit ka raportuar në lidhje me detyrat e kryera të paktën në baza tre-mujore dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Në vitin 2014 Komisioni i Auditimit i ka mbajtur gjithsej nëntë takime.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur kanë raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatës. Sidoqoftë, Komitetet nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së të njëjtëve. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit nuk është i përbërë nga numri i duhur i anëtarëve siç kërkohet me Kodin e Etikës për Qeverisje Korporative dhe është i përbërë vetëm nga dy anëtar. Komitetet tjera janë të përbërë nga 3 anëtarë ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 nuk ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur nëntë mbledhje.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit të vitit 2014, BD ka bërë një SWOT analizë kompanisë.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Plani i biznesit të bëhet në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Në vlerësimin e performancës së KE-së të integrohen edhe kriteret e përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe objektivat e vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të aprovohen rregullore për udhëtimet e punëtorëve, shpenzimet e marketingut, dhe shpenzimeve tjera të përfaqësimit.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.

- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.
- Të kompletohet Komisioni i Auditimit dhe të përbëhet nga të paktën tre anëtar siç është e përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

ANP - Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 23.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Bekim Jashari	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Naser Canolli	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Besnik Krasniqi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Fejzullah Krasniqi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Në vitin 2014, Bordi i ANP– Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a. ka qenë i pasuruar edhe nga një Drejtor i BD (HM) i cili ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksioneve të tij në kuadër të BD. Si rrjedhojë e dorëheqjes së bërë nuk është arritur të integrohet performanca e tij në vlerësimin e performancës së kompanisë dhe efektshmërisë së BD.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së ANP– Kontrolli Ajror “Adem Jashari” sh.a. dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	2.5
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.8
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	2.8
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	1.8
5	Performanca e Bordit	2.6
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	3.5
7	Komitetet e Bordit	3.3
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		2.93

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdoruara në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e Bordit në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e Bordit kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 20.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2014-2018 dhe 2015, por që ka ndryshuar nga i vitit 2013.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 20.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015. Gjithashtu, plani i biznesit nuk është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Në vitin 2014 BD nuk ka aprovuar ndonjë rregullore që përfshijnë çështje te punësimit. Sidoqoftë, BD ka aprovuar politika që përfshijnë çështje te punësimit sikurse: Rregullore e brendshme, Rregullore mbi politikën e stafit, Rregullore mbi përcaktimin e kostos bazë të pagesës.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore internet e aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit në mbledhjen me dt. 20.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD ka ngritur proces të strukturuar dhe aktiv për zgjedhjen e KE-së në vitin 2013. Vlen të ceket se gjatë votimit për përzgjedhjen e KE-së, kryesuesi i BD ka abstenuar për shkak të konflikt të interesit, ka deklaruar se ka lidhje familjare me të propozuarin.

Përshkrimi i punës së KE-së: Përshkrimi i KE-së është aprovuar nga BD dhe integruar në kuadër të Rregullores së brendshme, shtator 2011.

Performanca e KE-së: Me dt. 19.06.2015, BD vlerësoi performancën e KE-së për periudhën 01.01.2014-31.12.2014, përmes Formularit për vlerësimin e zyrtarëve të lartë të kompanisë. Vlerësimi i performancës së KE-së është bërë konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Vlen të cekim faktin se vlerësimin është bërë me notën maksimale për secilin kriter që ka qenë pjesë e vlerësimit dhe nuk janë dhene komente shtesë për të arsyetuar vlerësimin maksimal. Gjithashtu, nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit që duhet ti realizoj KE-ja.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së. Sidoqoftë, në biznes plan janë të paraparë trajnime që do të shfrytëzohen edhe nga KE, që mund të përmirësoj performancën e punës.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore, por në baza tre mujore.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 04.03.2015. Te Ardhurat e ANP për vitin 2014 kane treguar 3,708,081 qe krahasuar me planifikimin për vitin e njëjtë tregojnë rënie prej 35% dhe 8% rënie ne krahasim me vitin 2013. Shpenzimet totale te ANP kane qene për 21% më të ulëta sesa planifikimi, derisa fitimi neto (-1.073 mil) tregon variance negative prej rreth 111% ne krahasim me planifikimin. Eksproprijimi i pronave private , kontestet gjyqësore nga punëtorët e larguar nga puna ka ndikuar në performancë më të dobët.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: BD nuk ka vlerësuar politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve si dhe politikën e shpenzimeve të marketingut dhe shpenzime të tjera përfaqësimi.

Vlerësimi i Aseteve: Rivlerësimi i asetëve të ANP Kontrolli Ajror “Adem Jashar” sh.a. nuk është bërë në vitin 2014, por është bërë në vitin 2013.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të AJ për Pasqyrat financiare të audituara për vitin 2013 është bërë në mbledhjen e dt. 21.05.2014. Raporti parqet drejtë pasqyrat financiare të vitit 2013 ashtu siç kërkohet nga Standardet Ndërkombëtare për Raportimin financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin e biznesit për vitin 2015 aprovuar me dt. 20.10.2014 si dhe në raportet tremujore. Sidoqoftë, nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Njohuritë e BD: Asnjë nga Drejtorët e BD nuk e ka ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: Nuk ka ndonjë përpjekje apo strategji për të thithur financime nga BE. Sidoqoftë, BD ka bërë përpjekje për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE. BD angazhohet në baza vjetore në planifikimin afat-gjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare dhe atë me përpilimin e Planit të Biznesit. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk janë paraparë, Fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Objektivat e Bordit: Bordi nuk e ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: Bordi ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014, aprovuar me dt. 23.06.2015. Nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: Bordi nuk e ka përditësuar politikën mbi kompensimet e drejtorëve të Bordit. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e drejtorëve dhe zyrtarëve të NP-së siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Trajnimit: Asnjë nga Drejtorët e BD nuk e ka ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD nuk e ka bërë konfirmimin për vitin 2014 se asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, Bordi ka pasur dy Komitete aktive dhe atë: Komiteti për Mbikëqyrjen e Projekteve Kapitale dhe Komiteti për Burime Njerëzore.

Raportimet e Komitetit të Auditimit: Në vitin 2014, Komiteti i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Gjatë vitit 2014 Komitetet janë përbërë nga minimum 3 anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e Bordit janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 nuk ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur tetë mbledhje, prej tyre shtatë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje me Aksionarin. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi i çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit të vitit 2014, Bordi ka bërë një analizë të të gjitha çështjeve madhore.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efekshmërisë së Bordit:

- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave si rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Me rastin e vlerësimit të performancës së KE-së të argumentohen vlerësimet e kriterëve që kanë marr maksimumin e pikëve. Në vlerësimin e performancës së KE-së të integrohen objektivat e vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të aprovohen rregullore për udhëtimet e punëtorëve, shpenzimet e marketingut, dhe shpenzimeve tjera të përfaqësimit.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.

- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektivi të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Të gjithë Drejtorët e Bordit duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Bordi duhet të kryej në baza vjetore vet-vlerësimin sistematik të performancës së vet. Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.
- Të kompletohet Komisioni i Auditimit dhe të përbëhet nga të paktën tre anëtar siç është e përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Bordi duhet të mbajë të paktën dymbëdhjetë takime brenda një viti siç është e përcaktuar në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 17.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Asllan Vitaku	25.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Bajram Limani	25.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Naim Ferati	25.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Makfire Osmani	25.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Në vitin 2014, BD i KMDK ka qenë i pasuruar edhe me një Drejtor të BD (ER) i cili për të evituar konfliktin e interesit ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksioneve të tyre në kuadër të BD. Si rrjedhojë e dorëheqjes së bërë nuk është integruar performanca e tij në vlerësimin e performancës së kompanisë-së dhe efektshmërisë së Bordit.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KMDK-së dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zberthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.4
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	3.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.3
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	2.4
5	Performanca e Bordit	2.6
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	3.0
7	Komitetet e Bordit	3.6

8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		3.2

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 31.10.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2017, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 31.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. BD gjatë vitit 2014 ka miratuar politikën më poshtë që rregullojnë çështjet e punësimit dhe atë: Rregullore për strukturën Organizative, sistematizimin dhe Kategorizimin e vendeve të punës, Rregullore për pagat dhe kompensimet tjera, Rregulloren për mirësjelljen dhe procedurat ndaj punëtorëve për përgjegjësinë disiplinore. Gjithashtu, BD ka aprovuar edhe politika tjera sikurse Rregullore për përdorimin e makinerisë së rëndë Transportuese dhe Automjeteve të Udhëtimit, Rregullore për organizimin e brendshëm të kompanisë, Rregullore për kompensimet jashtë pagës baze dhe reprezentacionit.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore internet e aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit për vitin 2015 në mbledhjen e dt. 31.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD në vitin 2011 përmes institucionit të konkursit ekstern ka zhvilluar proces të strukturuar dhe aktiv për zgjedhjen e KE aktual. Kurse me Vendimin Nr. 07/2014 të datës 30/09/2014, BD pas vlerësimit të punës dhe performances ka vendosur që KE-së t'i vazhdohet mandati.

Përshkrimi i punës së KE-së: Detyrat dhe përgjegjësitë e KE-se janë të përcaktuara edhe në Rregulloren për organizimin e brendshëm të kompanisë.

Performanca e KE-së: BD në mbledhjen e mbajtur me dt. 24.02.2015 ka bërë vlerësimin e performancës vjetore për vitin 2014 të KE-së, ku vlerësohet një performancë tejet e lartë dhe pozitive, veçanërisht në ngritjen e inkasimit dhe të ardhurave të kompanisë. Vlerësimi në fjalë është bërë konform kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Vlen të cekim faktin se nuk janë dhene komente shtesë për të arsyetuar vlerësimin maksimal si dhe nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit që duhet ti realizoj KE-ja.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në çdo mbledhje të BD. Sidoqoftë, nuk ka mbajtur mbledhje Bordi çdo muaj gjatë vitit 2014.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 12.03.2015. KMDK në vitin 2014 kishte 32 klientë, respektivisht 2 më shumë se planifikimi për këtë vit që në përqindje do të thotë 6.6% më shumë. Faturimi poashtu tregon ngritje për rreth 148 mijë euro apo rreth 14% më shumë, derisa inkasimi i realizuar është vetëm 0.47% më shumë se planifikimi. Shpenzimet operative kanë qenë me te vogla për rreth 190 mijë euro apo rreth 12.42% që bëjnë që KMDK të përmbyll vitin me një performancë të kënaqshme në raport me planifikimin. Shkalla e inkasimit ka treguar norme prej 88% si rezultat i mospagimit të borxheve nga KRM-te dhe mosrespektimi i marrëveshjeve të KRM-ve me KMDK. Poashtu janë planifikuar grante në vlerë prej 600 mijë euro derisa janë pranuar nga qeveria vetëm 200 mijë euro. Plani fizik i menaxhimit të mbeturinave është tejkaluar për 27,800 tonelata apo rreth 14.13%. Mund të konkludojmë se KMDK ka performuar me sukses gjatë vitit 2014, pasiçë kemi ngritje të faturimit, shpenzime operative më të ulëta të ndodhura si dhe tejkalim të planit fizik të menaxhimit të mbeturinave.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: Në mars të vitit 2011, BD ka aprovuar Rregulloren për kompensimet jashtë pagës bazë dhe reprezentacionit.

Vlerësimi i Aseteve: BD në vitin 2014 nuk e ka bërë vlerësimin e asetëve të kompanisë. Sidoqoftë, në mbledhjen e dt. 31.01.2013, BD ka shqyrtuar raportin mbi vlerësimin vjetor të asetëve të kompanisë.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 12.03.2014, BD ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituar për vitin 2013, me plotësimet e dhëna gjatë diskutimeve. Ndërsa, në mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin të dt. 13.06.2014 është aprovuar raporti i AJ për Pasqyrat financiare të Audituar për vitin 2013 dhe letra dërguar menaxhmentit.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: BD në baza vjetore rishikon burimet potenciale të risqeve dhe atë më hartimin e biznes planit. Zhvillimi i deklaratës së riskut duhet të jetë më i detajuar dhe i plotë. BD ka krijuar Komitetin e emergjencave që ka pasur për detyrë që të ndërmarr aktivitetet në vijim: Identifikimi i llojeve të rreziqeve për çdonjërin nga deponitë sanitare, Klasifikimi i rreziqeve, Vlerësimi i rreziqeve dhe planeve operative për mbrojtje, siguri si dhe në planin e veprimit për dalje nga kriza. Etj. Pas vlerësimit të risqeve gjenerohen rekomandimet se si duhet vepruar për menaxhimin e risqeve në fjalë.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratatë të ndryshme:

Njohuritë e BD: Të gjithë drejtorët e BD kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 04.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: Përpjekjet dhe strategjia e organizatës për të thithur financime nga BE apo ndonjë investitor tjetër janë të paraparë në kuadër të planit të investimeve. Në kuadër të planit të biznesit është integruar edhe plani i investimeve ku janë paraparë investime kapitale që duhet bërë për periudhën për të cilën bëhet plani i biznesit. Bazuar në procesverbalet e mbledhjeve nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE. Sidoqoftë, BD mbetet i informuar për të gjitha investimet e bëra në ndërmarrje. Në planin e investimeve është paraparë edhe burimi i investimit, mirëpo është identifikuar vetëm si i brendshëm dhe i jashtëm dhe jo më i detajuar për burimin e financimit nga jashtë.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratatë të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 me dt. 17.03.2015. Nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezulton pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD ka përditësuar Politikën mbi Shpërblimet. Deklarata për politiken e kompensimit për BD dhe Zyrtarëve të Kompanisë, të cilën BD ka miratuar me dt. 02.05.2014. Kompensimet e Drejtorëve të BD janë

publikuar në Raportin vjetor për vitin 2014. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: BD ka marr vërejtje nga NJPMNP lidhur me vendimin e dt. 26.04.2014 për Kompensimin e Drejtorëve të BD sepse i njëjti është në kundërshtim me vendimin e këshillit të ministrave së ndërmarrjeve që subvencionohen nga buxheti i Republikës së Kosovës. BD ka diskutuar por nuk ka marr ndonjë vendim për abrogimin e vendimit në fjalë. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Kryesuesi nuk e ka konfirmuar se gjatë vitit 2014 Drejtorët e BD nuk kanë asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, KMDK përveç Komiteti të Auditimit ka pasur edhe dy Komitetet tjera aktive dhe atë: Komiteti për Emergjencat dhe Komiteti për Përafrimin e Standardeve të Deponive Sanitare

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i Auditimit raporton në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë vitit 2014 ka raportuar shtatë herë.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komitetit përkatës. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit dhe komitetet tjera janë të përbëra nga të paktën tre anëtarë ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 nuk ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje dhe atë shtatë mbledhje të rregullta, tri mbledhje të jashtëzakonshme dhe një mbledhje me Aksionarin. Vlen të ceket se një nga anëtarët e bordit (MO) ka munguar në tri nga mbledhjet e mbajtura. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi i çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit të viti 2015-2017, BD ka bërë një analizë të të gjitha çështjeve madhore.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave si rregullore që rregullojnë menaxhimin e reziqeve dhe përgjegjësisë sociale.

- Me rastin e vlerësimit të performancës së KE-së të argumentohen vlerësimet e kritereve që kanë marr maksimumin e pikëve. Në vlerësimin e performancës së KE-së të integrohen objektivat e vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës.
- Caktimi i objektiveve të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi i performancës së Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Të gjitha vendimet e Bordit duhet të jenë në harmoni me Ligjin mbi NP-të dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektiveve në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.
- Bordi duhet të mbajë të paktën dymbëdhjetë takime brenda një viti siç është e përcaktuar në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

N.P.H. Ibër-Lepenc sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 26.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Faton Gjyshinca	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Bajram Mustafa	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Gjatë vitit 2014, sikurse edhe gjatë vitit 2013, BD i N.P.H. Ibër-Lepenc ka funksionuar me vetëm dy Drejtor të BD pasi që katër Drejtorë (NZ, GJV, MM & IA) kanë dhënë dorëheqje për të evituar konfliktin e interesit.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së N.P.H. Ibër-Lepenc dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.1
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	1.8
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.8
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	2.2
5	Performanca e Bordit	2.6
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.0
7	Komitetet e Bordit	2.3
8	Mbledhjet e Bordit	3.8
Vlerësimi i përgjithshëm		2.95

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 11.11.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në tre biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2013, 2014 dhe 2015.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 11.11.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015, dhe se të njëjtat janë aprovuar brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për NP si dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Plani i biznesit është bërë në baza vjetore dhe jo në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD ka të aprovuara politika që rregullojnë çështjet e punësimit dhe atë: Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës; Rregulloren për lidhjen e marrëdhënies së punës dhe përgjegjësinë disiplinore; Rregulloren për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil; Rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare. BD ka aprovuar edhe statusin dhe strukturën organizative të kompanisë. Të gjitha rregulloret në fjalë janë aprovuar në vitin 2010 dhe 2011.

Politika mbi Çështjet e Financave: Çështjet e financës janë të përfshira në Rregulloren për Kontabilitet dhe Financa aprovuar në Tetor të vitit 2011.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore për Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Buxheti Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit që është pjesë e Planit të Biznesit 2015, aprovuar me dt. 11.11.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur me dt. 23.12.2014 ka caktuar Ushtuesin e Detyrës të KE-së deri në finalizimin e procesit të rregullt për zgjedhjen e KE-së të rregullt. Vendimi në fjalë është marr nga ana e BD pas kërkesës së NJPMNP për marrjen e këtij vendimi në funksion të mbarëvajtjes së rregullt të proceseve të punës në ndërmarrje.

Përshkrimi i punës së KE-së: BD ka aprovuar përshkrimin e punës të KE-së dhe të njëjtin e ka integruar në kuadër të dokumentit intern Statuti i kompanisë hidroekonomike Ibër-Lepenc aprovuar në vitin 2010.

Performanca e KE-së: Nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe aseteve të kompanisë. Vlen të ceket fakti se në baza

mujore dhe vjetore bëhen raportime mbi punën e KE-së, të njëjtat janë të koncentruar në afarizmin e përgjithshëm të kompanisë, dhe nuk janë të koncentruar në kompetencat e KE-së.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në çdo mbledhje të BD dhe atë përmes Raportit të punës të Kryeshefit Ekzekutiv.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 17.03.2015. Të hyrat e NPH Ibër Lepenc në krahasim me planifikimin kanë treguar 5.4% tejkalim që vërehet në kategorinë e të hyrave nga energjia elektrike, të hyrat tjera dhe ato financiare derisa të hyrat nga uji dhe të hyrat nga ujitja kanë treguar mosrealizim të planifikimit (të hyrat nga uji me rreth 0.3 % dhe ato nga ujitja me rreth 9.89%). Kompania ka treguar performancë të mirë në kategorinë e të hyrave nga energjia elektrike që i referohet kushteve të mira hidrologjike në pjesën e dytë të vitit derisa të hyrat nga uji kanë treguar realizim më të ulët se planifikimi si rezultat i kërkesave më të ulëta nga TC Kosova A dhe Kosova B, derisa kompanitë tjera kanë realizuar planifikimin në tërësi. Shpenzimet e përgjithshme të NHP Ibër Lepenci janë realizuar në nivel më të ulët 99.96%. Në kategoritë e shpenzimeve kemi tejkalime të vogla që janë rezultat i furnizimit të KRU Prishtina respektivisht liqenit të Badovcit me ujë që ka rezultuar edhe me angazhime shtese të resurseve. Humbja ka qenë me e vogël se planifikimi për rreth 268 mijë euro apo mbi 6%.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Në Maj të vitit 2010, BD ka aprovuar Rregulloren për Kompensimet Jashtë Pagës Bazë, Reprerentacionit dhe Dhënien e Ndihmave Solidare.

Vlerësimi i Aseteve: Në kuadër të Planit të Biznesit është integruar edhe Planit i Zhvlerësimit të Aseteve për Vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e datës 28.03.2014 është miratuar raporti i Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2013. Raporti i Auditorit të jashtëm për vitin 2013 nuk përmban asnjë të gjetur dhe si rrjedhojë BD nuk ka dorëzuar letë rmenaxhmentit për arsye të faktit që opinioni i auditorit të jashtëm ka qenë i rezervë.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve përcaktohen në baza vjetore me përpilimin e planit të biznesit të përfshira në kuadër të planit strategjik të kompanisë. Burimet e risqeve për vitin vijues janë të parapara në kuadër të planit të biznesit për vitin 2015. Sidoqoftë nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Njohuritë e BD: Një nga Drejtorët e BD (BM) nuk e ka ndjekur trajnimin e thirrur nga NJPMNP, “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: BD nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar për të thithur financime nga BE. Planifikimi financiar afatgjatë për sigurimin e të hyrave më kohë është pjesërisht i mbuluar në kuadër të planifikimit strategjik dhe projekteve investive brenda planit të biznesit. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga institucionet brenda apo jashtë Kosovës.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat e ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete për BD dhe Komitetet. Objektivat e parapara në Planin e Biznesit janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektiveve.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 me dt. 17.03.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezulton pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD ka përditësuar Politikën mbi Shpërblimet. Deklarata për politiken e kompensimit për BD dhe Zyrtarëve të Kompanisë, të cilën BD ka miratuar me dt. 23.04.2014. Kompensimet e Drejtorëve të BD janë publikuar në Raportin vjetor për vitin 2014. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi nuk e ka konfirmuar se gjatë vitit 2014 asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, BD ka pasur 3 Komitete aktive dhe atë: Komiteti i Financave, Komiteti për Staf dhe Shpërblime, Komisioni për Huluntim, Zhvillim dhe Investime Kapitale. Në fillim të vitit fiskal nuk është bërë rishikimi i strukturës së komiteteve ad-hoc. Kjo rezulton për shkak të numrit të vogël të anëtarëve të Bordit.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i Auditimit raporton në lidhje me detyrat e kryera të paktën në baza mujore. Në vitin 2013 Komisioni i Auditimit ka raportuar në dymbëdhjetë (12) mbledhjet.

Objektivat e Komiteteve: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komitetit përkatës. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit nuk përbëhet nga numri i duhur i anëtarëve dhe në përbërjen e saj ka vetëm dy anëtar. Gjithashtu, pjesë e dy anëtarëve të Komitetit të Auditimit është edhe UD Kryesuesi i BD (ndonëse i kryen punët dhe detyrat e Kryesuesit të njëjtit nuk i është lëshuar vendimi nga Aksionari për UD Kryesues). Sidoqoftë, është me rëndësi të ceket fakti se emërimi i Komisionit të Auditimit nuk varet nga BD sepse është kompetencë e Aksionarit.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë: BD ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta mujore dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme. Pjesëmarrja e Drejtorëve të BD në mbledhjet e mbajtura ka qenë e rregullt.

Vlerësimi i çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit të vitit 2014 BD ka përfshirë në pika të shkurta avantazhet dhe disavantazhet e çështjeve madhore në kuadër të Planit Strategjik.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Sidoqoftë, asnjë nga Procesverbalet nuk janë të nënshkruar nga sekretari, dhe atë procesverbalet janë nënshkruar nga dy zyrtarë të ndryshëm. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga UD Kryesuesi i BD.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Plani i biznesit të bëhet në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të gjithë Drejtorët e BD duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi i Bordit duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen si dhe duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.
- Sekretari i Kompanisë duhet të marr pjesë në mbledhjet e Bordit dhe të jetë personi përgjegjës për përgaditjen e procesverbaleve dhe aktiviteteve tjera të kërkuara nga ana e Bordit.
- Të kompletohet Komisioni i Auditimit dhe të përbëhet nga të paktën tre anëtar siç është e përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Vlerësimi i performancës së Kompanive Rajonale të Ujitjes

Janë gjithsej dy kompani rajonale të ujitjes dhe atë:

- KU Drini i Bardhë sh.a., Pejë
- KU Radoniqi-Dukagjini sh.a., Gjakovë

Performanca e kompanive rajonale të ujitjes është si vijon:

KU Drini I Bardhë sh.a

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 15.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ali Sefaj	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Fadil Kabashi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Beqir Metaj	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Shkodran Gaxherri	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KU Drini i Bardhë dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	2.4
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	1.7
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	2.6
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	2.4
5	Performanca e Bordit	2.2
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.0
7	Komitetet e Bordit	1.6
8	Mbledhjet e Bordit	3.8
Vlerësimi i përgjithshëm		2.58

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 30.10.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në katër biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Planet Strategjike: Planeti operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 30.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015, dhe se të njëjtat janë aprovuar brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për NP si dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Planit i

biznesit është bërë në baza vjetore dhe jo në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD në vitin 2014 ka aprovuar dy rregullore dhe atë rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës si dhe rregulloren për përdorimin e automjeteve. Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës është rregullorja e vetme që është aprovuar nga ana e BD që rregullon çështjet e punësimit.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore interne të aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit që është pjesë e Planit të Biznesit 2015, aprovuar me dt. 30.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: Në viti 2011, BD ka shpallur konkurs publik dhe pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit është zgjedhur KE aktual. BD në mbledhjen e dt. 25.06.2014 pas marrjes së lejës nga Aksionari ka marr vendim që t'i vazhdohet kontrata e punës KE-së edhe për 3 (tre) vite, dhe atë deri në vitin 2017.

Përshkrimi i punës së KE-së: BD ka aprovuar përshkrimin e vendit të punës për KE-në e kompanisë.

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin me datën 14.08.2014, BD ka rishqyrtuar performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. Ky vlerësim ka qenë i mangët, i përgjithshëm dhe është bërë për Menaxhmentin e Kompanisë. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Gjithashtu, vlerësimi nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore dhe se të njëjtat bëhen çdo tre muaj.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 18.03.2015. Për vitin 2014 kompania ka planifikuar ujitje të 2280.00 ha. Inkasimi i planifikuar në euro për vitin 2014 është 119,700 €. Faturimi për vitin 2014 ka qenë 191,500 €, derisa të hyrat tjera kanë rezultuar 71,800 €. Të hyrat e përgjithshme të realizuar në 2014 janë 312,772€. Totali i shpenzimeve është parapare te jete 167,599€, derisa kanë ndodhur 300,457 €. Fitimi i planifikuar ka qene 23,901 derisa është realizuar 12,314. Kompania ka treguar performance solide në kategorinë e të hyrave, derisa kemi tejkalim të shpenzimeve si dhe realizim më të ulët të fitimit të planifikuar.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: Nuk ka aprovuar BD politika të shpenzimeve për udhëtime dhe dieta te punonjësve si dhe politikën e shpenzimeve te marketingut dhe shpenzime te tjera përfaqësimi.

Vlerësimi i Aseteve: BD nuk e ka bërë vlerësimin e asetëve të kompanisë në vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen me dt. 30.05.2014, BD aprovon Raportin e auditorit të jashtëm dhe pranohen gjetjet e auditorit. Ndërsa, me dt. 14.08.2014 është miratuar raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Audituarra për vitin 2013 dhe letrës së menaxhmentit dërguar nga Auditori i jashtëm.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Bordi në Planin e Biznesit për vitin 2015 ka përmendur në mënyrë sipërfaqësore dhe të mangët dobësitë e kompanisë. Dobësitë e integruara janë të përgjithshme dhe nuk janë relevante

me dobësitë dhe sfidat me të cilat duhet të orientohet ndërmarrja në të ardhmen. Nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Njohuritë e BD: Tre nga Drejtorët e BD (AS, FK & SHG) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur nga NJPMNP me dt. 03.12.2014, “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporatave” dhe vetëm një nga Drejtorët e BD ka ndjekur trajnimin Drejtorët tjerë të BD e kanë ndjekur trajnimin në fjalë.

Angazhimi i BD: Bazuar në procesverbalet e mbledhjeve vërehet se BD nuk luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE apo institucionet tjera qeveritare apo jo-qeveritare. Kjo dëshmohet edhe me faktin se BD nuk ka hartuar ndonjë strategji me projekte konkrete për të thithur financime nga jashtë. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që janë integruar në kuadër të planit të biznesit dhe atë prioritetet në investime kapitale.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete për BD. Objektivat e parapara në Planin e Biznesit janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD nuk e ka bërë raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014.

Kompensimet: Për shkak të performancës së dobët të kompanisë nuk janë realizuar të gjitha obligimet financiare ndaj BD dhe se të njëjtit nuk kanë marr asnjëherë bonus apo ndonjë kompensim tjetër financiar. Kompensimet e Kryesuesit dhe Drejtorëve të BD janë publikuara në ueq faqen e NJPMNP në kuadër të raportit vjetor ashtu siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore gjate Vendim-marrjes

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD me dt. 22.03.2014 ka konfirmuar se gjatë vitit 2013 Drejtorët e BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD. Sidoqoftë, Kryesuesi nuk e ka barë konfirmimin se gjatë vitit 2014 Drejtorët e BD nuk kanë asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Komitetet aktive: Për shkak të performancës së dobët të kompanisë, BD nuk ka mundur të formojë komitete tjera dhe gjatë vitit 2014 ka ekzistuar vetëm Komisioni i Auditimit.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i Auditimit ka raportuar në lidhje me detyrat e kryera të paktën në baza tre-mujore dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Në vitin 2014 Komisioni i Auditimit i ka mbajtur gjithsej tetë takime.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komitetit të auditimit por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komiteti para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komitetit përkatës. Sidoqoftë, Komisioni i Auditimit nuk i ka vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së të njëjtit. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komiteti i Auditimit është i përbërë nga 3 anëtar. Në të gjitha Procesverbalet e Komisionit të Auditimit figuron anëtari FK, edhe pse i njëjti nuk është në vendimin themelimit të Komisionit të Auditimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave me dt. 25.05.2009. Kjo ndodh për arsye se në vendimin e themelimit të KA, bënë pjesë edhe Kryesuesi i BD, i cili sipas Ligjit mbi NP dhe Kodit të Etikës nuk ka drejtë të jetë pjesë i KA. Sidoqoftë, është me rëndësi të ceket fakti se emërimi i Komisionit të Auditimit nuk varet nga BD sepse është kompetencë e Aksionarit.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 nuk ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur dhjetë mbledhje, duke përfshirë mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin (NJPMNP). Vlen të ceket se një nga anëtarët e bordit (SHG) ka munguar në dy nga dhjetë takimet e mbajtura dhe një anëtar i bordit (BM) ka munguar në një nga dhjetë mbledhjet e mbajtura. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: BD në Planin e Biznesit për vitin 2015 ka përmendur në mënyrë sipërfaqësore dhe të mangët dobësitë e kompanisë. Dobësitë e integruara janë të përgjithshme dhe nuk janë relevante me dobësitë dhe sfidat me të cilat duhet të orientohet ndërmarrja në të ardhmen.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës. Sidoqoftë, procesverbalet duhet të jenë më të kompletuar dhe më të detajuar duke përfshirë të gjitha diskutimet e zhvilluara gjatë mbarëvajtjes së mbledhjes.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Plani i biznesit të bëhet në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave, punësimit, menaxhimit të rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet lidhur me shpenzimet e udhëtimit, shpenzimeve të marketingut dhe shpenzimeve tjera të përfaqësimit.
- Të gjithë Drejtorët e BD duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.

- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Të bëhet vet-vlerësimi i performancës së Bordit. Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të ngriten komitete që do të jenë në funksion të përmirësimit të performancës dhe përmirësimit të proceseve brenda kompanisë. Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektiveve në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.
- Të kompletohet Komisioni i Auditimit dhe të përbëhet nga të paktën tre anëtar siç është e përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të përmirësohet kualiteti i procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit.

KU Radoniqi – Dukagjini sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 12.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Canë Delija	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Abdulla Krasniqi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Artan Nimani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Ismet Neziri	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KU Radoniqi-Dukagjini dhe efektshtërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	2.8
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.1
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	2.4
5	Performanca e Bordit	2.2
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.0
7	Komitetet e Bordit	3.3
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		3.01

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdoruara në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 27.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në tre biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2013, 2014 dhe 2015.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 27.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015. Gjithashtu, plani i biznesit nuk është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD në vitin 2014 nuk ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. Sidoqoftë, në vitet e mëhershme BD ka aprovuar Rregulloren mbi Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, Rregullore për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorëve Rregullore për Mbrojtje në punë, e aprovuar me dt. 28.09.2010, etj.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore internet e aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit që është pjesë e Planit të Biznesit 2015, aprovuar me dt. 27.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD në vitin 2012 ka ngritur proces të strukturuar dhe aktiv në përzgjedhjen e KE-së, dhe atë pas përfundimit të institucionit të konkursit ekstern.

Përshkrimi i punës së KE-së: BD ka aprovuar përshkrimin e punës të KE-së.

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin me datën 20.06.2014, BD ka rishqyrtuar performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Gjithashtu, vlerësimi nuk është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së. Sidoqoftë, në biznes plan janë të paraparë trajnime që do të shfrytëzohen edhe nga KE, që mund të përmirësoj performancën e punës.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Në çdo mbledhje të BD, KE raporton mbi gjendjen financiare në Komani. Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 13.03.2015. Sipërfaqet e planifikuara dhe të realizuar për ujitje për kompaninë për vitin kalendarik 2014 tregojnë se ka tejkalim për 4.43% apo për rreth 190 ha. Sipërfaqet e planifikuara dhe realizuara për vitin kalendarik 2014 tregojnë realizim prej 90.61% që do të thotë se kemi ndryshim negativ në realizim prej 9.39%. Te hyrat totale tregojnë 742,000€. Shpenzimet 739,000€. Shpenzimet totale tregojnë tejkalim prej 4.87% apo 34,435€. Të hyrat e përgjithshme tregojnë tejkalim në krahasim

me planifikimin për 26,004€ apo 7.44 %. Fitimi është për 1,000€ më i lartë se planifikimi. Në përgjithësi mund të themi se kompania ka treguar performance të mirë ku kemi tejkalim në sipërfaqet e ujitura, derisa kemi një ngecje të Dukagjini. Të hyrat kanë tejkaluar planifikimin dhe atë me rreth 7.44%.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: ND nuk ka rishqyrtuar politikat mbi shpenzimet e udhëtimeve, dieta të punonjësve dhe marketingut.

Vlerësimi i Aseteve: BD në vitin 2014 nuk e ka bërë vlerësimin e asetëve të kompanisë. Sidoqoftë, në mbledhjen me dt. 31.01.2013, ka miratuar raportin e Komisionit Qendror për regjistrimin e Asetëve për vitin 2012.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 18.03.2014, BD ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të Audituarra për vitin 2013 dhe Letër Menaxhmentit. Raporti i Auditorit të Jashtëm nuk ka gjetje dhe as rekomandime dhe se pasqyrat financiare paraqesin drejtë pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin e biznesit aprovuar me dt. 27.10.2014 të pjesa mbi planin e implementimit dhe analizën e rreziqeve. Bordi ka ofruar disa propozime/rekomandime për menaxhimin e këtyre risqeve. Nuk ka plan konkret për menaxhimin e risqeve të identifikuar në kuder të planit të biznesit.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e BD: Tre nga Drejtorët e BD (AN, AK&IN) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronë shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.” Vetëm një nga Drejtorët e BD ka ndjekur trajnimin në fjalë.

Angazhimi i BD: Nuk ka ndonjë përpjekje apo strategji për të thithur financime nga BE. Bazuar në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE. Në kuadër të planit të biznesit ndërmarrja bën planifikimin afat-gjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare. BD ka rishikuar nevojat për investime kapitale në kuadër të planit të biznesit si pjesë e planifikimit strategjik, programi i PIP-it për investime kapitale, grande nga Qeveria.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka aprovuar raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 në mbledhjen me dt. 23.06.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD nuk ka përditësuar politikën mbi shpërblimet dhe gjatë vitit 2014 BD nuk i është paguar bonus apo ndonjë shpërblim tjetër. Shpërblimet e Drejtorëve të BD janë publikuar brenda Raportit vjetor të viti 2014. Në ueb faqe të NJPMNP nuk janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Të gjithë Drejtorët e BD kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD nuk e ka bërë konfirmimin se gjatë vitit 2014 se asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, kanë qenë aktive dy komitete dhe atë Komisioni i Auditimit dhe Komiteti për Lobim dhe Definim të Aseteve. Vlen të cekim se Komiteti për Lobim dhe Definim të Aseteve që ka qenë aktiv nga fillimi i vitit fiskal deri me 31.03.2014 dhe është riaktivizuar nga dt. 01.08.2014.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Në vitin 2014, Komiteti i Auditimit ka raportur në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Të gjitha komitetet janë të përbërë nga të paktën tre anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e BD

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 nuk e ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur dhjetë mbledhje. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi i çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit janë të paraparë avantazhet dhe disavantazhet e çështjeve madhore dhe janë të paraparë investimet që duhet ndërmarr.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Plani i biznesit të bëhet në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet lidhur me shpenzimet e udhëtimit, shpenzimeve të marketingut dhe shpenzimeve tjera të përfaqësimit.

- Të gjithë Drejtorët e BD duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.
- Bordi duhet të mbajë të paktën dymbëdhjetë takime brenda një viti siç është e përcaktuar në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Vlerësimi i performancës së Kompanive Rajonale të Ujësjetës

Janë gjithsej gjashtë kompani rajonale të ujësjetës dhe atë:

- KUR Prishtina sh.a., Prishtinë
- KRU Hidrodrini sh.a., Pejë
- KRU Hidroregjioni Jugor sh.a., Prizren
- KRU Mitrovica sh.a., Mitrovicë
- KRU Hidromorva sh.a., Gjilan
- KRU Radoniqi sh.a., Gjakovë

Performanca e kompanive rajonale të ujësjetës është si vijon:

KUR Prishtina sh.a

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 08.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ejup Hashani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Kujtim Xhelili	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Bajram Jashari	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Adem Duriqi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KUR Prishtina dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbërthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.0
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.1
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	3.4
5	Performanca e Bordit	2.5
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	2.5
7	Komitetet e Bordit	3.3
8	Mbledhjet e Bordit	4.6
Vlerësimi i përgjithshëm		3.06

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 30.10.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2017, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë kryesisht i njëjtë në tre biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2013-2015, 2014-2016 dhe 2015-2017.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 30.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Në vitin 2013 BD nuk ka aprovuar asnjë rregullore që rregullon çështjet e punësimit. Por, në vitet e mëhershme BD ka aprovuar rregullore që rregullojnë çështje të punësimit dhe atë: rregullore mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, statusin e shoqërisë aksionare me dt. 01.07.2009, Kodin e Mirësjelljes me 15.04.2006, njësia për shqycje dhe inspektim – themelimi, struktura organizative, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e saj në Maj të vitit 2010, rregullore mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale, rregullore mbi ndalimin e pirjes së duhanit në objektet e kompanisë me dt. 15.01.2007, rregullore për mbrojtje në punë.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore internet e aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit që është pjesë e Planit të Biznesit 2015-2017, aprovuar me dt. 30.10.2014 dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD ka ngritur proces të ristrukturuar për zgjedhjen e KE të NP-së. Është shpallur konkurs ekstern dhe pas vlerësimit të kandidatëve të interesuar dhe që kanë hyrë në rrethin e ngushtë është vendosur për zgjedhjen e GJV në pozitën e KE.

Përshkrimi i punës së KE-së: Në kuadër të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës është përfshirë edhe përshkrimi i KE të kompanisë.

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin me datën 24.06.2014, BD ka rishqyrtuar performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Gjithashtu, vlerësimi nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në anët ku ka hapësirë për tu zhvilluar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhet në baza mujore dhe se të njëjtat bëhen gjithashtu edhe çdo tre muaj.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 17.03.2015. Uji i faturuar ka treguar ngritje e poashtu edhe numri i konsumatorëve (kemi 6737 konsumatorë mbi planifikimin). Humbjet e ujit në nivele të larta kanë shoqëruar njësitë në Lipjan, Podujeve Drenas dhe Shtime dhe atë me mbi 50%, derisa njësia e Prishtinës ka treguar rezultat më të mirë me rreth 47%. Realizimi i prodhimit të ujit tregon 84.45 % në krahasim me planifikimin. Totali i të ardhurave të faturuara është realizuar në nivelin prej 85% në krahasim me planifikimin derisa inkasimi ka treguar realizim prej 99%. Mund të konkludohet se KRU Prishtina ka treguar performancë të mirë në aspektin e ngritjes së numrit të konsumatorëve, zvogëlimit të humbjeve në krahasim me vitet paraprake si dhe inkasimit në nivelin 99%, derisa kategoritë tjera (prodhimi, faturimi) kanë treguar ngecje në realizim. Poashtu KRU Prishtina ka treguar rezultat pozitiv financiar prej rreth 250 mijë euro.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: Në vitin 2008, BD ka aprovuar rregulloren mbi kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar, gradimeve profesionale dhe dhënien e ndihmave

solidare. Ndërsa, në vitin 2013, BD ka rishqyrtuar politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta te punonjësve si dhe politikën e shpenzimeve te marketingut dhe shpenzime te tjera përfaqësimi.

Vlerësimi i Aseteve: BD nuk e ka bërë vlerësimin e asetëve të kompanisë në vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: BD në mënyrë unanime me dt. 21.03.2014, ka aprovuar raportin e AJ mbi auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2013 me vërejtjet e dhëna. Raporti i auditorit të jashtëm ka qenë i kualifikuar ku janë gjetur tri kualifikime. Ndërsa, në mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin të dt. 24.06.2014, është miratuar raporti i auditorit të jashtëm me rekomandimet e dhëna nga ana e BD.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në raportin vjetor dhe në planin e biznesit. Ndërmarrja përmes objektivave strategjike për vitin 2015-2017 në kuadër të planit të biznesit ka integruar planin për menaxhimin e risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Njohuritë e BD: Asnjë nga Drejtorët e BD nuk e ka ndjekur trajnimin e thirrur nga NJPMNP me dt. 03.12.2014, “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: BD ka strategji për të thithur financime nga BE dhe investitorët tjerë vendor dhe ndërkombëtar. Strategjia është integruar në planin e biznesit. BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE. Në kuadër të planit të biznesit ndërmarrja bën planifikimin afat-gjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga institucionet e ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete për BD dhe Komisionin e Auditimit. Objektivat e parapara në Planin e Biznesit janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit, aprovuar me dt. 18.05.2015. Nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: Me dt. 18.04.2014, BD ka marr vendim për përditësimin e politikës mbi shpërblimet. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimin e pranuar nga NJPMNP, në vitin 2014, Drejtorët e BD kanë marr vendime që kanë qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP. Gjithashtu, BD nuk i ka dorëzuar paraprakisht NJPMNP agjendën e mbledhjeve si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet në mënyrë të shkruar siç janë të parapara në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD kanë bërë zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD ka konfirmuar me dt. 05.02.2014 dhe dt. 18.03.2015 se gjatë vitit 2013 dhe 2014, asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, BD ka pasur 3 Komitetet aktive dhe atë: Komiteti për Përcjelljen e Investimeve Kapitale, Komiteti për Staf dhe Shpërblime dhe Komiteti për Financa.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i Auditimit ka raportuar në lidhje me detyrat e kryera të paktën në baza tre-mujore dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komitetit të auditimit por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komiteti para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komitetit përkatës. Sidoqoftë, Komisioni i Auditimit nuk i ka vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së të njëjtit. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit është i përbërë nga 3 anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë: BD ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta mujore dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme. Pjesëmarrja e Drejtorëve të BD në mbledhjet e mbajtura ka qenë e rregullt dhe pasur kuorum në të gjitha mbledhjet e mbajtura. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit 2015-2017, BD ka bërë një analizë konkrete dhe të detajuar për të gjitha çështjet madhore dhe ka përshkruar vendimet që duhet merren për menaxhimin e të njëjtave.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari i Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave, menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraparak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të bëhet vlerësimi i aseteve të kompanisë.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet lidhur me shpenzimet e udhëtimit, shpenzimeve të marketingut dhe shpenzimeve tjera të përfaqësimit.
- Vendimet e Bordit duhet të jenë gjithmonë në përputhje me Ligjin mbi NP-të dhe Kodin e Etikës për Qeverisje Korporative të Ndërmarrjeve Publike.
- Të ndërmerren masa të menjëhershme për eliminimin e vërejtjeve/njoftimeve eventuale lëshuar nga NJPMNP.
- Të gjithë Drejtorët e BD duhet të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.

- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për të gjitha Komitetet aktive në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

KRU Hidrodrini - Pejë sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 15.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Shkelzen Hyseni	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Gjelosh Gojani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Rexhë Abazi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KRU Hidrodrini - Pejë dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.4
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	1.8
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.7
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	3.4
5	Performanca e Bordit	2.6
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.7
7	Komitetet e Bordit	2.0
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		3.22

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdoruara në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 27.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2014 dhe 2015.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 27.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015. Gjithashtu, plani i biznesit nuk është bërë për një periudhë më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, etj. Në vitin 2014 BD ka ndryshuar dhe plotësuar rregulloren mbi kompensimin e beneficioneve dhe të ardhurave tjera të punëtorëve, Strategjinë e menaxhmentit për pagesën e të ardhurave të punëtorëve në bazë të performancës së njësive operative, etj. Gjithashtu, BD në vitet e mëhershme ka miratuar Rregulloren mbi marrëdhënien e punës, Rregullore mbi përdorimin e veturave zyrtare, Rregullore mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorëve, Rregullore mbi mbajtjen e dosjeve personale të punësuarve, etj.

Politika mbi Çështjet e Financave: BD ka aprovuar dokumentin - Matrica e Autorizimeve për Menaxhmentin e KUR Hidrodrini, në të cilët janë paraparë në mënyrë shumë të qartë çështjet e financave.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Në kuadër të Rregullores mbi marrëdhënien e punës është mbuluar ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimeve në vendin e punës. Nuk ka rregullore të veçantë për Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit të integruar në kuadër të Planit të Biznesit dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: Me mbledhjen e dt. 25.03.2014, BD ka vendosur për vazhdimin e mandatit të zyrtarëve kryesor të kompanisë edhe për tre vite, duke përfshirë edhe atë të KE-së i cili është zgjedhur në vitin 2011 përmes konkursit ekstern.

Përshkrimi i punës së KE-së: BD ka aprovuar përshkrimin e vendit të punës të integruar në kuadër të Statusi i KUR Hidrodrini. Ky dokument është aprovuar në vitin 2008 në të cilën KE-së i referohet si Drejtori Menaxhues.

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin me datën 16.06.2014, BD ka rishqyrtuar performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Gjithashtu, vlerësimi nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në çdo mbledhje të BD në përjashtim për periudhën prill-maj dhe korrik-gusht, kur rishikimi është bërë në baza dy mujore.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve operacional të planifikuar kundrejt të realizuara si dhe krahasimet me vitet paraprake, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, që është aprovuar me dt. 27.02.2015. Prodhimi i ujit në kompani në m³ ka rezultuar me 29782872 m³ dhe realizim kundrejt planifikimit me 97.32%. Faturimi në m³ ka qene me 87.17% realizim në krahasim me planifikimin, derisa humbjet kanë qenë 71% (plani ka qenë 67%). Shpenzimet janë tejkualuar për rreth 5.3% në krahasim me planin. Inkasimet në vitin 2014 kanë tejkualuar planin dhe atë me rreth 11.41%. Shkalla në përqindje e faturimit me inkasimin tregon normën prej 66% që tregon rezultat me të mirë se planifikimi për rreth 2% (planifikimi për 2014 ishte 64%). Numri i konsumatorëve është rritur për 6230 apo rreth 18% në krahasim me planifikimin. Edhe faturat e lëshuara kanë qenë më të larta për

6362 cope apo afër 19%. Përveç numrit të konsumatorëve më të lartë dhe inkasimit në krahasim me planifikimin, treguesit tjerë tregojnë ngecje.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Çështjet e shpenzimeve për mëditje, udhëtime dhe dieta, dhe shpenzime tjera të përfaqësimit janë të përfshira në Rregulloren mbi Kompensimin e beneficioneve dhe të ardhurave tjera të punëtorëve, të hyrë në fuqi 28.10.2011

Vlerësimi i Aseteve: BD në Raportin Vjetor analizon vlerën e asetëve dhe bën krahasimin e asetëve me vitin paraprak, meqë rast gjatë vitit 2014 është shtuar vlera e asetëve.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin të dt. 18.06.2014 është miratuar raporti i AJ për Pasqyrat financiare të Audituarat për vitin 2013 dhe letrës për menaxhmentin dërguar nga Auditori i Jashtëm. Opinioni i auditorit të jashtëm është i rezervuar dhe se pasqyrat financiare paraqesin drejtë pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në Planin e Biznesit e viti 2015, BD ka bërë një analizë të faktorëve të brendshëm – përparësitë dhe dobësitë, si dhe të faktorëve të jashtëm – përparësitë dhe dobësitë. Nuk ka plan të veçantë për menaxhimin e rreziqeve por në kuadër të planit të biznesit janë të parapara aktivitetet që do të ndikojnë në menaxhimin e pjesshëm të rreziqeve në fjalë.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e BD: Të gjithë Drejtoret e BD e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: Në kuadër të planit të biznesit 2015, BD ka bërë Planin e investimeve për grandet qeveritare dhe donacionet e donatorëve për vitet që është bërë plani i biznesit. BD nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar për të thithur financime nga BE. Vlen të ceket fakti se në vitin 2014 kompania ka përfituar një donacion prej 22 milion Euro nga Banka Gjermane dhe Zyra Zvicerane. BD angazhohet të paktën një herë në vit në planifikimin financiar afat-gjatë dhe atë me rastin e përpilimit të biznes planit. Me rastin e përpilimit të biznes planit, në kuadër të planit të investimeve kapitale BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga qeveria dhe donatorë të jashtëm.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë vetëvlerësimin për vitin 2014 me dt. 28.05.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD në mbledhjen e dt. 23.09.2014, duke pasur parasysh performancën e kompanisë dhe raportin e ZRRUK për performancën e kompanisë, nuk e ka aprovuar Deklaratën për Politikën e Kompensimit të BD dhe Zyrtarëve të Lartë për vitin 2013. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimin e pranuar nga NJPMNP, në vitin 2014, Drejtoret e BD kanë marr vendime që kanë qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP. Gjithashtu, BD nuk i ka dorëzuar paraprakisht NJPMNP agjendën e mbledhjeve si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet në mënyrë të shkruar siç janë të parapara në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Të gjithë Drejtorët e BD kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD me dt. 21.07.2015 ka konfirmuar se gjatë vitit 2014 asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014 BD nuk ka formuar asnjë Komitet tjetër për arsye se nuk e ka parë të arsyeshme sepse të gjitha lëmit i ka mbuluar BD dhe Komisioni i Auditimit

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Në vitin 2014, Komisioni i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komitetit të Auditimit por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komiteti para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve. Sidoqoftë, Komisioni i Auditimit nuk i ka vendosur në asnjë dokument objektivat në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës. Si bazë e objektivave janë funksionet e komitetit të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit nuk është i përbërë ashtu siç kërkohet në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative dhe i njëjti është i përbërë vetëm nga 2 anëtarë. Sidoqoftë, është me rëndësi të ceket fakti se emërimi i Komisionit të Auditimit nuk varet nga BD sepse është kompetencë e Aksionarit.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur trembëdhjetë mbledhje, duke përfshirë mbledhjen e përgjithshme me aksionarin dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit. Vlen të ceket fakti se një nga Drejtorët e BD (GJG) në pesë nga takimet e zhvilluara ka marr pjesë përmes lidhjes së dyanshme telefonike. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit për vitin 2015, BD ka bërë një analizë të faktorëve të brendshëm – përparësitë dhe dobësitë, si dhe të faktorëve të jashtëm – përparësitë dhe dobësitë. Gjithashtu, në planin e biznesit janë bërë aktivitetet kryesore që duhet ndërmerren si dhe veprimet që duhet të ndërmerren për realizimin e aktiviteteve në fjalë.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari I Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efekshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Plani i biznesit të bëhet në periudha më afatgjate siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e menaxhimit të rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.

- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të bëhet vlerësimi i aseteve të kompanisë.
- Vendimet e Bordit duhet të jenë gjithmonë në përputhje me Ligjin mbi NP-të dhe Kodin e Etikës për Qeverisje Korporative të Ndërmarrjeve Publike.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Të formohen komitete që mund të kontribuojnë në përmirësimin e proceseve të punës brenda kompanisë.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektiveve pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për Komisionin e Auditimit në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komisionit duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të kompletëhet Komisioni i Auditimit dhe të përbëhet nga të paktën tre anëtar siç është e përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 11.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Naser Bajraktari	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Galip Hoda	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Bujar Hasani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Drita Grazhda	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Sahit Ukaj	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KRU Hidroregjioni Jugor dhe efektshmërisë së Bordeve. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.2
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.5
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.5
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	2.4
5	Performanca e Bordit	2.6
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.0
7	Komitetet e Bordit	2.6
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		3.12

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 31.10.2014 ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2017, në të cilën është integruar Misioni dhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në tre biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2013-2015, 2014-2016 dhe 2015-2017.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar në mbledhjen e dt. 31.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD ka aprovuar politika që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përshkrimet dhe detyrat e punës, strukturën organizative, shpërblimet e punëtorëve, etj.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore internet e aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit të integruar në kuadër të Planit të Biznesit dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: KE aktual është zgjedhur në vitin 2010 pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit nga ana e BD. Në vitin 2014 në mbledhjen e 04.08.2014, BD ka vendosur që t'i vazhdohet kontrata e punës KE-së edhe për një vit.

Përshkrimi i punës së KE-së: Në mbledhjen me dt. 04.03.2010 BD bënë përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të Kryeshefit Ekzekutiv, meqë rast edhe merr vendimin për hapjen e konkursit për përzgjedhjen e tij. Gjithashtu detyrat dhe përgjegjësitë e KE-së janë të përshkruara edhe në dokumentin Vlerësimi i kryerjes së punës të përcaktuara më statusin e kompanisë.

Performanca e KE-së: BD vlerëson performancën e KE-së në baza vjetore. Vlerësimi për vitin 2014 është bërë në bazë të Formularit të vlerësimit të kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e lartë të kompanisë. Nuk janë specifikuar detaje specifike në realizimin e projekteve të parapara paraprakisht, nuk janë paraparë ngecjet dhe përparësitë e KE-së gjatë performancës së punës.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në çdo mbledhje të BD dhe atë përmes Raportit njoftues të Kryeshefit Ekzekutiv. Nuk ka pasur raportime mujore nga BD duke pasqyruar se në vitin 2014 janë mbajtur gjithsej dhjetë mbledhje.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 05.03.2015. Prodhimi në m³ ka treguar mosrealizim të planifikimit dhe atë me rreth 12.47%. Faturimi poashtu ka qenë më i ulët se plani me rreth 13.49%. Inkasimi nga uji ka treguar mosrealizim prej rreth 11,87%, derisa inkasimi total tregon mosrealizim prej 12.94%. Numri i konsumatorëve është me i vogël për 583 sosh në krahasim me planin për vitin 2014 apo 1.40%. Shpenzimet janë për 1.89% më të ulëta se plani e poashtu edhe uji i pafaturuar është me i ulët se planifikimi për vitin 2014 dhe atë me 11.74%. Uji i faturuar si % tregon 41.07%. Norma e arkëtimit e përgjithshme tregon 75.47%, ku prijnë institucionet dhe amvisëritë derisa konsumatorët komercial kanë norme të ulëta. Në përgjithësi kompania ka treguar performancë të dobët, në të gjithë treguesit operativ dhe financiar krahasuar me planifikimin në përjashtim të shpenzimeve operative që janë më të ulëta se plani për 1.89%.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Çështjet e shpenzimeve për mëditje, udhëtime dhe dieta, dhe shpenzime tjera të përfaqësimit janë të rregulluara në Rregulloren për Pagave, Shtesave dhe të tjera për të punësuarit. Rregullorja bazë është aprovuar në vitin 2009, ndërsa është modifikuar pjesërisht në vitin 2012.

Vlerësimi i Aseteve: Në vitin 2014 nuk është bërë vlerësimi i asetëve të kompanisë dhe për herë të fundit është bërë në vitin 2007 nga një vlerësues i jashtëm.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 19.06.2014, BD ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013. Ndërsa, në mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin të dt. 15.07.2014 është aprovuar raporti i AJ për Pasqyrat financiare të Audituarat për vitin 2013 dhe letra dërguar menaxhmentit. Raporti i AJ për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013 ka qenë i jokualifikuar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në biznes planin 2015-2017 aprovuar me dt. 31.10.2014. Sidoqoftë, risqet e parapara janë përshkruar shumë shkurt dhe pa ndonjë informacion të mbështetur me burime kredibile. Nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e BD: Dy nga anëtarët e BD (BH&NB) nuk e ka ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: BD nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar për të thithur financime nga BE. Në dokumentet e shqyrtuara, në asnjë prej tyre nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër. BD angazhohet të paktën një herë në vit në planifikimin financiar afat-gjatë dhe atë me rastin e përpilimit të biznes planit. Me rastin e përpilimit të biznes planit, në kuadër të planit të investimeve kapitale BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fonde të kapitalit.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete për BD dhe Komisionin e Auditimit. Objektivat e parapara në Planin e Biznesit janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimit, aprovuar me dt. 15.06.2015. Nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: Në mbledhjen e BD të dt. 29.04.2014, është shqyrtuar dhe aprovuar propozimi i Komitetit të Auditimit për kompensimin-bonusin e Drejtorëve të BD. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: BD në vitin 2014 ka marr vërejtje nga ana e NJPMNP lidhur me terminin e mbajtjes së mbledhjes së përgjithshme vjetore me Aksionarin. BD nuk ka marr vendime të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP.

Trajnimi: Dy nga anëtarët e BD (BH&NB) nuk e ka ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Konflikti i Interesit: Kryesuesi i BD me dt. 22.07.2015 ka konfirmuar se gjatë vitit 2014 asnjë Drejtor i BD nuk ka asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, BD ka pasur tri Komitete aktive dhe atë: Komiteti për Staf dhe Shpërblime, Komiteti i Financave dhe Komiteti për Hulumtime & Teknologji.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Komisioni i Auditimit raporton në lidhje me detyrat e kryera të paktën në baza tre-mujore dhe atë përmes Komiteteve Drejtuese.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur kanë raportuar para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit që nga viti 2011 nuk ka qenë i përbërë nga 3 anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Gjithashtu, UD Kryesuesi i Komitetit nuk ka vendim nga Aksionari për të qenë UD Kryesuesi i Komitetit.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 nuk ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur dhjetë mbledhje, duke përfshirë mbledhjen e përgjithshme vjetore me Aksionarin (NJPMNP). Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit 2015-2017, BD ka bërë një analizë mbi avantazhet dhe disavantazhet mbi çështjet madhore të kompanisë. Në dokumentin në fjalë janë ta paraparë edhe aktivitetet që duhet ndërmerren për avantazhet dhe disavantazhet e evidentuara.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha janë të firmosura nga Kryesuesi i BD.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave dhe nivelin e aprovimit të shpenzimeve për menaxhmentin, si dhe politika që rregullojnë menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kritereve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të bëhet vlerësimi i aseteve të kompanisë.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Të gjithë Drejtorët e Bordit duhet të jenë të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Bordi të bashkëpunojë ngushtë me NJPMNP që të gjitha aktivitetet të jenë në harmoni me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet tjera në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.

- Të kompletohet Komisioni i Auditimit dhe të përbëhet nga të paktën tre anëtar siç është e përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

KRU Mitrovica sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 16.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Fehmi Kajtazi	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Nysret Gërxhaliu	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Remzi Sylejmani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Haki Maxhuni	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KRU Mitrovica dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kriterë të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kriterë të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	2.8
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	1.8
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.1
4	Shkalla e përrthithjes së fondeve	2.0
5	Performanca e Bordit	2.2
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	1.8
7	Komitetet e Bordit	3.3
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		2.65

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kriterë të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 31.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2017, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2014-2016 dhe 2015-2017.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 31.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: BD gjatë vitit 2014 nuk ka miratuar asnjë rregullore që rregullojnë çështjet e punësimit duke përfshirë sigurinë në punë, kompensimet, përskrimet dhe detyrat e punës. BD në vitin 2010 dhe 2011 ka aprovuar rregulloret në vijim: Rregulloren mbi Marrëdhënien e punës së punonjësve; Rregulloren mbi Sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës; Rregulloren mbi regjistrimin e mjeteve dhe burimet e mjeteve të kompanisë; Rregullore për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil); Rregullore për përdorimin e automjeteve.

Politika mbi Çështjet e Financave: BD nuk ka aprovuar rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: BD nuk ka aprovuar politika të veçanta interne që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD ka aprovuar Planin e Buxhetit të integruar në kuadër të Planit të Biznesit dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: Në vitin 2014 nuk ka pasur ndryshimin në zyrtarin kryesor të kompanisë dhe se BD në vitin 2012 ja ka vazhduar mandatin KE-së për 3 vite.

Përshkrimi i punës së KE-së: Përshkrimi i KE-së është integruar në kuadër të Rregullores mbi Sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës, i hyrë në fuqi me dt. 03.08.2011.

Performanca e KE-së: Në mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin me datën 25.06.2014, BD ka rishqyrtuar performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së përmes së cilës vlerësohet lidhja ekzekutive e KE-së me BD, roli prej liderit në planifikimin e programeve dhe zbatimin e tyre, rolin e KE-së në menaxhimin e kompanisë, menaxhimin e stafit dhe asetëve të kompanisë. Gjithashtu, vlerësimi nuk është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së. Sidoqoftë, në biznes plan janë të paraparë trajnime që do të shfrytëzohen edhe nga KE, që mund të përmirësoj performancën e punës.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara bëhet në baza mujore.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 13.02.2015. Prodhimi i ujit në vitin 2014 ka treguar 17.8% më shumë se plani i biznesit dhe 13% në raport me vitin 2013. Humbjet në ujë kanë qenë 59%, derisa në planifikim janë parapare 49%. Inkasimi ka qenë 8.5% më i ulët se planifikimi 2014. Uji i faturuar është rreth 2% më i lartë se plani i biznesit, derisa shkalla e inkasimit është 48% kundrejt 54% të planifikuara. Numri i konsumatorëve ka qenë për 4.8% më i lartë se plani. Faturimi i ujit ka qenë 2% më i lartë se planifikimi për vitin 2014. Shpenzimet operative janë për rreth 6% më të ulëta se planifikimi për vitin 2014. Mund të themi se KRU Mitrovica ka treguar performance solide në tregues të caktuar dhe atë në prodhimin e ujit, faturimin e tij, numrin e konsumatorëve si dhe shpenzimet operative, derisa mosrealizim kemi në inkasim si dhe rritje të humbjeve në krahasim me planin.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta të punonjësve: Me datë 19.09.2009, BD miratoi Rregulloren mbi kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar, gradimeve profesionale dhe dhënien e ndihmave solidare.

Vlerësimi i Aseteve: Vlerësimi i fundit i asetëve të NP-së është bërë nga një vlerësues i jashtëm në vitin 2007.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: BD ka shqyrtuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013 me dt. 30.05.2014 dhe ka konkluduar se raporti nuk është i nivelit të duhur dhe se katër vërejtjet e dhëna nuk qëndrojnë dhe si rrjedhojë është vendosur që të mos aprovohet raporti në fjalë. Raporti i AJ për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013 nuk është aprovuar edhe në mbledhjen e përgjithshme me Aksionarin mbajtur me dt. 25.06.2014. Opinioni i AJ për Pasqyrat Financiare të Audituarat për vitin 2013 është i kualifikuar dhe janë identifikuar gjetje të theksuara.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin e biznesit 2015-2017. Sidoqoftë, nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Njohuritë e BD: Dy nga Drejtorët e BD (NG&HM) nuk e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: BD nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar për të thithur financime nga BE. Në dokumentet e shqyrtuara, në asnjë prej tyre nuk vërehet se BD luan rol aktiv në përpjekjet për të përthithur fonde nga BE apo ndonjë investitor tjetër. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorët tjerë.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka bërë raportin e vetëvlerësimi për vitin 2014 me dt. 16.07.2015. Nuk janë caktuar objektivat e Bordit në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD nuk e ka përditësuar Deklaratën për politikën e kompensimit për drejtorët e BD. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet me nenin 20.4 të Ligjit mbi NP. Gjithashtu, në raportin vjetor janë publikuar kompensimet e Drejtorëve të BD për vitin 2013 si shumë totale.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përmbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2013 nuk është aprovuar brenda afateve të parapara kohore. Sidoqoftë, raportet tjera janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: BD ka marr vërejtje nga NJPMNP për Deklaratën mbi politikën e kompensimit të Drejtorëve të BD. Më tutje, BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacionet tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Konflikti i Interesit: Të gjithë Drejtorët e BD kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi nuk e ka konfirmuar se gjatë vitit 2014, Drejtorët e BD nuk kanë asnjë konflikt interesi në raport me ushtrimin e pozitës së tyre si Drejtor i BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, BD ka pasur gjashtë Komitetet aktive dhe atë: Komisioni i Auditimit, Komiteti për Staf dhe Shpërblime, Komiteti për Hulumentim & Teknologji, Komiteti për Financa, Komiteti për Mbikëqyrjen e Distribuimit të Ujit si dhe Komiteti për Kontrollim të Rrjetit & Zvogëlim të Humbjeve Teknike. Nuk përditësohen nevojat për të ngritur Komitete ad-hoc në fillim të vitit fiskal.

Raportimet e Komitetit të Auditimit: Në vitin 2014, Komiteti i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur dymbëdhjetë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komiteteve por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komitetet para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komiteteve përkatëse. Sidoqoftë, Komitetet aktive nuk i kanë vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës së tyre. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisioneve respektive të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Të gjitha Komitetet aktive gjatë vitit 2014 kanë qenë të përbërë nga të paktën tre anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur katërbëdhjetë mbledhje. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuoromit. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit 2015-2017, BD ka bërë një analizë të çështjeve madhore dhe përpjekjet për realizimin e të njëjtave.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës dhe të gjitha janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari I Korporatës. Në shumë pika të rendit të ditës në procesverbal mungon konstatimi apo vendimi i BD pas trajtimit të të njëjtave.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës. Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave dhe nivelin e aprovimit të shpenzimeve nga menaxhmenti, rregullore që rregullojnë menaxhimin e risqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Të rifreskohen politikat e punësimit dhe të burimeve njerëzore brenda kompanisë.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të bëhet vlerësimi i aseteve të kompanisë.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Të gjithë Drejtorët e Bordit duhet të jenë të ndjekin trajnimet e thirrura nga NJPMNP.
- Bordi të njoftojë NJPMNP në lidhje me përgjegjësitë si dhe informacione tjera të rëndësishme për kompaninë.
- Të gjitha raportet duhet të aprovohen me kohë, duke përfshirë edhe Raportin e AJ për Pasqyrat Financiare. Kundërshtimet eventuale lidhur me gjetjet e AJ duhet të argumentohen dhe dokumentohen në mënyrë që të sqarohen paqartësitë dhe procedohet tutje me aprovim brenda afateve të caktuara kohore.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet tjera në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komiteve duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.

- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

KRU Hidromorava sh.a

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e BD nga tabela më poshtë është bërë me dt. 10.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Avdyl Hasani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Elhame Shefkiu	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Xhelal Selmani	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Azem Mujku	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KRU Hidromorava dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kriterë të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kriterë të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.0
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	2.1
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.0
4	Shkalla e përthithjes së fondeve	4.6
5	Performanca e Bordit	2.4
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	4.7
7	Komitetet e Bordit	2.6
8	Mbledhjet e Bordit	4.6
Vlerësimi i përgjithshëm		3.37

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kriterë të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 31.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2017, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e aprovuara nga ana e Bordit, respektivisht në atë të vitit 2014-2016 dhe 2015-2017.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 31.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Politikat mbi Çështjet e Punësimit: Në vitin 2014 BD nuk ka aprovuar ndonjë rregullore mbi çështjet e punësimit. Sidoqoftë, në vitin 2011, BD ka aprovuar politika që përfshijnë çështje të ndryshme të punësimit dhe atë: Rregullore mbi kodin e mirësjelljes; Rregullore mbi përshkrimin e detyrave të punës; Rregullore mbi themelimin e marrëdhënies së punës; Rregullore për mbrojtje në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës; Rregullore për mbrojtje kundër zjarrit.

Politika mbi Çështjet e Financave: Nuk ka aprovuar BD rregullore të veçantë interne për çështjet e Financës.

Politikat mbi Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale: Nuk ka rregullore internet e aprovuara nga BD që mbulojnë Menaxhimin e Risqeve dhe Përgjegjësi Sociale.

Aprovimi i Buxhetit Vjetor: BD aprovon buxhetin vjetor bazuar në planin strategjik të aprovuar nga vete BD, në bazë të të cilit autorizohen shpenzimet dhe amortizohen asetet e NP dhe atë konform Ligjit për NP (nr. 03/L-087) si dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

2. Zhvillimi dhe Performanca e KE-së

Për vlerësimin e kriterit mbi zhvillimin dhe performancën e KE-së janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Zgjedhja e KE-së: BD në vitin 2014 ka caktuar dy ushtrues detyre të KE-së dhe dy herë ka shpallur konkursin publik për të parin e kompanisë. Pas publikimit të dytë dhe pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit me dt. 27.08.2014 ka zgjedhur KE-në e kompanisë.

Përshkrimi i punës së KE-së: Detyrat dhe përgjegjësitë e KE-së janë të përshkruara në Rregulloren mbi përshkrimin e detyrave të punës të aprovuar më 02.12.2011

Performanca e KE-së: KE ka filluar punën në muajin Shtator të viti 2014 dhe si rrjedhojë BD nuk ka arritur që të bëjë vlerësimin e plotë të performancës. Sidoqoftë, nuk ka dokument të veçantë në të cilën BD e vlerëson performancën e KE-së.

Plani për zhvillimin personal të KE-së: Nuk ka plan specifik për zhvillimin personal të KE-së që do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e performancës duke u koncentruar në kompetencat ku ka hapësirë për tu zhvilluar dhe përmirësuar.

3. Monitorimi i Performancës së NP-së dhe Menaxhimi i Risqeve

Për vlerësimin e kriterit mbi monitorimin e performancës së NP-së dhe menaxhimin e risqeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Raportet mujore: Rishikimi i rezultateve aktuale kundrejt atyre të realizuara si dhe ardhurave dhe kostove të planifikuara kundrejt të realizuara nuk bëhen në baza mujore.

Raportet tre mujore: BD i kryen raportet tre mujore konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe atë në baza tremujore bëhet rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe të dalave të mjeteve monetare, rishikimi i numrit të punonjësve, rishikimi i pasqyrës së të hyrave dhe shpenzimeve.

Raportet vjetore: Analizën e punës për ndryshimet e treguesve financiarë dhe operacional të planifikuar kundrejt të realizuara, BD e ka bërë me Raportin Vjetor për vitin 2014, aprovuar me dt. 13.03.2015. Prodhimi i ujit në m³ ka qenë 99.44% në krahasim me planifikimin. Faturimi në m³ 88.43%. Faturimi në euro ka treguar trend negativ dhe atë me afër 9% rënie në krahasim me planifikimin për vitin 2014. Numri i konsumatorëve të regjistruar ka treguar ngrije për 307 apo 1.25% në krahasim me planifikimin për vitin 2014. Inkasimi në euro poashtu tregon mosrealizim sipas planit dhe atë me rreth 13%. Të hyrat totale në vitin 2014 kanë qenë 1,263,649, që kundrejt planifikimit prej 1,639,632 tregon mosrealizim prej 375,983 apo rreth 22%. Shpenzimet totale tregojnë realizim prej 99.61% në krahasim me planifikimin, derisa fitimi/humbja ka treguar humbje prej -94 mije euro në krahasim me 275 mije të planifikuara. Në përgjithësi performanca e Hidromoravës vlerësohet si jo e mire pasiçë kemi nivel të ulët të treguesve operativ dhe financiar, respektivisht ngecje në realizim me planifikimin për vitin 2014. I vetmi tregues pozitiv llogaritet rritja e numrit të konsumatorëve dhe atë për rreth 307.

Politikat e shpenzimeve për udhëtime, dieta të punonjësve dhe marketing: Në Mbledhjen e mbajtur me 02.12.2011, BD ka aprovuar Rregulloren mbi kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar, dhënien e ndihmave solidare.

Vlerësimi i Aseteve: BD nuk e ka bërë vlerësimin e asetëve të kompanisë në vitin 2014.

Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm: Në mbledhjen e dt. 22.05.2014, BD ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e AJ për Pasqyrat Financiare të Audituar për vitin 2013. Opinioni i AJ është i parezervë / pakualifikuar por me theksim të çështjeve të caktuara, dhe se pasqyrat financiare paraqesin drejtë pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Burimet e risqeve dhe menaxhimi i tyre: Burimet potenciale të risqeve janë të parapara në planin e biznesit 2015-2017. Sidoqoftë, nuk ka plan konkret me shkrim për menaxhimin e këtyre risqeve.

4. Shkalla e Përthithjes së Fondeve

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përthithjen e fondeve janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklarata të ndryshme:

Njohuritë e BD: Të gjithë Drejtorët e BD e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “ Ndërmarrjet publike në pronë shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Angazhimi i BD: Në kuadër të Planit të Biznesit 2015-2015, aprovuar me dt. 31.10.2014, është integruar edhe plani investimeve kapitale në të cilin plan janë prezantuar projektet kapitale me rëndësi për ndërmarrjen si përpjekje për të arritur investime nga Qeveria e Kosovës, KK Gjilan si dhe Donatorët tjerë potencial. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë

strategji për të arritur fonde nga BE. Në Raportin vjetor për vitin 2014 aprovuar me dt. 13.03.2015 janë prezantuar Kontaktet me Donatorët, që vërehet se ndërmarrja ka qenë aktiv në përpjekjet për të arritur fonde nga BE dhe donatorët tjerë. BD ka rishikuar nevojat për marrjen e fondeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, KK Gjilan dhe donatorëve tjerë në kuadër të Planit të Biznesit 2015-2015 aprovuar me dt. 31.10.2014, respektivisht pjesë e planit për investime kapitale.

5. Performanca e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përmirësimin e performancës së BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Objektivat e BD: BD nuk i ka përkthyer Planin e Biznesit në objektiva konkrete dhe se të njëjtat janë të parapara vetëm në Planin e Biznesit. Objektivat në fjalë janë të përgjithshme dhe për gjithë ndërmarrjen, dhe nuk janë definuar aktivitetet kryesore të BD në realizimin e atyre e objektivave.

Vetëvlerësimi: BD ka aprovuar raportin e vetëvlerësimit për vitin 2014 me dt. 27.03.2015. Nuk janë caktuar objektivat në fillim të vitit fiskal dhe nuk ka ndonjë plan konkret për të përmirësuar vlerat e NP që rezultojnë pas procesit të vetëvlerësimit.

Kompensimet: BD nuk e ka miratuar Deklaratën për Kompensim të Drejtorëve të Bordit dhe Zyrtarëve kryesorë të kompanisë. Kompensimet e Kryesuesit dhe Drejtorëve të BD, si dhe të Anëtarëve të Komiteteve aktive janë publikuar në Raportin vjetor për vitin 2014 aprovuar me dt. 13.03.2015. Në ueb faqe të NJPMNP janë publikuar kompensimet e zyrtarëve kryesorë të kompanisë siç kërkohet në nenin 20.4 të Ligjit mbi NP.

6. Përputhshmëria me Ligjin për NP-të dhe Përbushja e Detyrimeve Ligjore

Për vlerësimin e kriterit lidhur me përbushjen e detyrimeve ligjore janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Aprovimi i raporteve: Të gjitha raportet janë aprovuar me kohë dhe atë konform Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Respektimi i Ligjeve: Bazuar në konfirmimet e pranuar nga NJPMNP, takimet e zhvilluara me Drejtorët e BD dhe në procesverbalet e mbledhjeve të BD nuk është evidentuar se BD ka marr ndonjë vendim që ka qenë në kundërshtim me Ligjin mbi NP gjatë vitit 2014. BD ka njoftuar në lidhje me përgjegjësitë dhe informacione tjera të rëndësishme siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Trajnimi: Të gjithë Drejtorët e BD e kanë ndjekur trajnimin e thirrur me dt. 03.12.2014 nga NJPMNP për qeverisje korporative, respektivisht trajnimin “Ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe funksionimi i qeverisjes korporative.”

Konflikti i Interesit: Drejtorët e BD e kanë bërë Zotimin mbi Respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike. Kryesuesi i BD me dt. 21.07.2015 ka konfirmuar se gjatë vitit 2014 nuk ka pasur asnjë konflikt interesi nga Drejtorët e BD.

7. Komitetet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me komitetet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Komitetet aktive: Gjatë vitit 2014, BD ka pasur aktiv vetëm Komisionin e Auditimit.

Raportimet e Komisionit të Auditimit: Në vitin 2014, Komisioni i Auditimit ka raportuar në Bord të paktën në baza tre mujore dhe se gjatë kësaj periudhe ka mbajtur shtatë mbledhje.

Objektivat e Komitetit: Nuk është bërë vlerësim i ndarë vetëm për punën e Komisionit të Auditimit por konsiderohet si vlerësim formal kur ka raportuar komiteti para BD, ku edhe është bërë miratimi i rekomandimeve të Komisionit. Sidoqoftë, Komisioni i Auditimit nuk i ka vendosur në asnjë dokument objektivat e tyre në fillim të vitit në bazë të të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës. Si bazë e objektivave janë funksionet e komisionit të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

Përbërja e Komiteteve: Komisioni i Auditimit është i përbërë nga 3 anëtar ashtu siç është e përcaktuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

8. Mbledhjet e Bordit

Për vlerësimin e kriterit lidhur me mbledhjet e BD janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Mbledhjet e mbajtura: BD në vitin 2014 ka plotësuar obligimin mbi numrin e mbledhjeve që duhet mbajtur të përcaktuara në nenin 24.1 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, respektivisht të

paktën dymbëdhjetë takime në vjet. BD në vitin 2014 ka mbajtur katërbëdhjetë mbledhje dhe atë dhjetë mbledhje të rregullta dhe katër të jashtëzakonshme. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në vitin 2014 është plotësuar kriteri i kuorumit dhe pjesëmarrja ka qenë e plotë. Grafiku i mbledhjeve është e përmbledhur në Qeverisjen Korporative e siguruar për NJPMNP si dhe në raportin vjetor.

Vlerësimi I çështjeve madhore: Në Planin e Biznesit 2014-2016, BD ka bërë një analizën SWOT të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Nuk ka më shumë informata dhe detaje mbi secilin nga faktorët e përfshirë në këtë analizë.

Procesverbalet: Procesverbalet mbahen në rregull nga ana e Sekretarit të Korporatës. Të gjitha procesverbalet janë të firmosura nga Kryesuesi i BD dhe Sekretari I Korporatës.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e bërë janë gjeneruar rekomandimet më poshtë që të jenë në dispozicion të Drejtorëve të Bordit me qëllim të përmirësimit të performancës dhe efektshmërisë së Bordit:

- Misioni dhe vizioni i kompanisë të rishikohet të paktën një herë në tre vite dhe të jetë në harmoni me aktivitetet e planifikuara.
- Të aprovohen rregullore që rregullojnë çështjet e financave dhe nivelin e aprovimit të shpenzimeve nga menaxhmenti, rregullore që rregullojnë menaxhimin e risqeve dhe përgjegjësisë sociale.
- Të rifreskohen politikat e punësimit dhe të burimeve njerëzore brenda kompanisë.
- Performanca e KE-së duhet të bëhet në baza vjetore në një dokument formal konform kriterëve të përcaktuara në nenin 27.26 nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të objektivave të vitit për të cilën është duke u bërë vlerësimi i performancës.
- Caktimi i objektivave të KE-së duhet të bëhet në fillim të vitit fiskal.
- Vlerësimi i performancës së KE-së të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Të bëhet plani i zhvillimit personal i KE-së duke u koncentruar në vlerësimin e performancës dhe kompetencat ku vërehet se ka hapësirë për tu përmirësuar.
- Të hartohet një dokument nga strukturat kompetente brenda kompanisë mbi rreziqet potenciale që mund të kenë ndikimin në performancën e kompanisë si dhe një plan konkret që do të jetë në funksion të kompanisë në menaxhimin apo tejkalimin e këtyre rreziqeve.
- Të bëhet një vlerësim më i theksuar gjatë procesit të planifikimit financiar afatgjatë për të siguruar të hyra në kohë të burimeve financiare.
- Në baza mujore të rishikohen rezultatet aktuale kundrejt të buxhetuara, të ardhurat dhe kostot e planifikuara për kompaninë.
- Të bëhet vlerësimi i aseteve të kompanisë.
- Të hartohet një strategji me projekte konkrete me qëllim të thithjes së donacioneve nga të gjithë donatorët potencial, qeveritare apo joqeveritare, vendore apo ndërkombëtar.
- Bordi në fillim të vitit fiskal duhet t'i caktoj objektivat kryesore që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar.
- Objektivat e Bordit duhet të jenë të bazuara në planin e biznesit, duhet të caktohen në fillim të vitit fiskal dhe duhet të bëhet vlerësimi i këtyre objektivave pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal.
- Vet-vlerësimi duhet të përfundojë me një plan konkret së çka duhet ndryshuar me qëllim të përmirësimit të performancës së Bordit në të ardhmen. Vet-vlerësimi sistematik i performancës së Bordit të bëhet në fillim të vitit fiskal për vitin paraprak.
- Të formohen komitete që mund të kontribuojnë në përmirësimin e proceseve të punës brenda kompanisë.
- Në baza vjetore duhet të bëhet Konfirmimi nga Kryesuesi i Bordit se asnjë nga anëtarët nuk kanë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre në Bord. Konfirmimi në fjalë duhet të bëhet për vitin vijues në mbledhjen e fundit të vitit paraprak.
- Të vendosen objektivat për Komisionin e Auditimit në fillim të vitit fiskal dhe të bëhet vlerësimi i objektivave në fjalë pas përfundimit të vitit fiskal dhe fillimit të vitit të ri fiskal. Objektivat e komisionit duhet të bazohen në objektivat e Bordit si dhe në Planin e Biznesit.
- Të bëhet një analizë e detajuar dhe e dokumentuar e të gjitha çështjeve madhore të kompanisë.

KRU Radoniqi – Gjakovë sh.a.

Zhvillimi i intervistave me Drejtorët e Bordit të Drejtorëve nga tabela më poshtë është bërë me dt. 24.06.2015.

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Leonard Shehu	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja
Hajdar Grezda	24.12.2008	Deri në zgjedhjen e bordeve të reja

Nga viti 2012 Bordi i Drejtorëve të KRU Radoniqi funksionon me vetëm dy Drejtor të BD si rezultat i dorëheqjes së Drejtorit të BD (AGJ) nga funksioni i tij.

Tabela më poshtë paraqet vlerësimin e performancës së KRU Radoniqi - Gjakovë dhe efektshmërisë së BD. Për vlerësimin e performancës së kompanisë janë përdorur gjithsej tetë kritere të ndryshme dhe secili kriter është zbrëthyer në disa nën-kritere të ndryshme, të cilat do të shtjellohen në vlerësimin më poshtë:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi
1	Planifikimi strategjik dhe vendim-marrja	3.1
2	Zhvillimi dhe performanca e KE-së	3.2
3	Monitorimi i performancës së NP-së dhe menaxhimi i risqeve	3.6
4	Shkalla e përhithjes së fondeve	3.4
5	Performanca e Bordit	2.4
6	Përputhshmeria me Ligjin për NP-të dhe përmbushja e detyrimeve ligjore	2.7
7	Komitetet e Bordit	2.0
8	Mbledhjet e Bordit	4.2
Vlerësimi i përgjithshëm		3.07

Informatat më poshtë shtjellojnë në mënyrë më të detajuar vlerësimin e secilit kriter nga tabela më lartë dhe atë konform nën-kritereve të përdorura në këtë vlerësim.

1. Planifikimi Strategjik dhe Vendim-marrja

Për vlerësimin e kriterit mbi angazhimin e BD në planifikimin strategjik janë përdorur disa nën-kritere të ndryshme dhe për secilin nën-kriter janë integruar deklaratat të ndryshme:

Misioni dhe Vizioni: Të gjithë Drejtorët e BD kanë njohuri të mirë mbi misionin dhe vizionin e NP-së. Vizioni dhe misioni i kompanisë bëhet në baza vjetore dhe atë me aprovimin e Biznes Planit. BD në mënyrë unanime në mbledhjen e dt. 30.10.2014, ka aprovuar Biznes Planin e vitit 2015-2017, në të cilën është integruar edhe Vizioni i kompanisë. Sidoqoftë, misioni dhe vizioni i kompanisë ka qenë i njëjtë në dy biznes planet e mëhershme të aprovuara nga ana e Bordit.

Planet Strategjike: Plani operacional, plani financiar dhe planet tjera strategjike janë aprovuar me dt. 30.10.2014, në kuadër të Planit të Biznesit për vitin 2015-2017. Gjithashtu, plani i biznesit është bërë për një periudhë tre vjeçare siç është e përcaktuar në nenin 26.16, pika e parë, nga Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

